

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - OPSTINA VUCITRN
Nr. / Br. 21990/25
Tër. i Eq. / Br. sh. -1-
Data: / Datum: 19.05.25
VUSHTPRI - VUCITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 81/25 19/05/2025

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Ju fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **29 maj 2025 (e enjte), me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 24 prill 2025;
2. Propozim- vendim për ndarjen e dekoratave për Ditën e Çlirimit;
3. Draft-Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr.209/20 për dhënien e dekoratave;
4. Propozim- vendim për emërim të komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave në Komunën e Vushtrrisë;
5. Kërkesë për mbështetje financiare për znj. Ajmane Ferati;
6. Informatë lidhur me Qarkoren Buxhetor 2026/01;
7. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit Nr.14403/25 për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e proceduarve të dhënies në shfrytëzim të shërbimeve të transportit me automarimang brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë;
8. Pyetje dhe përgjigje.



Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA OF KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITRIN

Nr. / Br.: 21987/25

Fër. i fq. / Br. st. -2-

Data: / Datum: 19.05.25

VUSHTBRI - VUÇITRIN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 79/25, 19/05/2025

PËR:	Kuvendin e Komunës
NGA:	Melihate Basholli Latifi Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
PËRMES:	Sekretarisë së Kuvendit
TEMA:	Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 19.05.2025

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **19 maj 2025** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Propozim- vendim për ndarjen e dekoratave për Ditën e Çlirimit:

- **Lidhur me çmimin “Emblema e Vushtrrisë”, KPF-ja me shumicë votash vendosi:**
Që ky çmim t'i ndahet z. Dibran Përçuku. Kurse, nga propozimi të hiqet emri i z. Arsim Gërxhaliu.
- **Lidhur me çmimin “Hasan Prishtina”, KPF-ja rekomandoi:**
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
- **Lidhur me çmimin “Pena e Artë”, KPF-ja rekomandoi:**
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
- **Komiteti për Politikë dhe Financa rekomandoi që çmimi “Krenaria e Sportit të Vushtrrisë”, t'i ndahet Klubit të Hendbollit “Samadrexha U18” (femrat) dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.**

2. Draft-Rregullore për dhënien e dekoratave.

Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:

Që të bëhen këto përmirësime dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim:

- *Komisioni ose Drejtoria të konsultohen me Zyrën Ligjore se ky draft a duhet të jetë plotësim-ndryshim i rregullores apo rregullore e re;*
- *Hiqet pika 1.5 e nenit 4 – Çmimi “SHKA Hasan Prishtina 1996-1998”;*
- *Neni 13 – Çmimi “Poeteshat shqiptare”, vendi i parë – 1000€, vendi i dytë – 750€, vendi i tretë – 500€. Çmimi “debutuesja” - 300€, pjesëmarrësit që nuk fitojnë çmim – 100€*

3. Propozim- vendim për emërim të komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në Komunën e Vushtrisë.

Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:

Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

4. Kërkesë për mbështetje financiare për znj. Ajmane Ferati.

Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:

Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

5. Informatë lidhur me Qarkoren Buxhetore për vitin 2026/01.

Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:

Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB ///25 ///05/2025

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E KATËRT E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, PËR VITIN 2025, MBAJTUR MË: 24 PRILL 2025

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën **10:15**. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Basri Menxhiqi, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Faton Hyseni, Leonora Gërguri, Fakte Dushi, Fatmire Cecelia, Gresa Muli, Gentiana Rama, Kushtrim Hyseni, Mek Selaci, Jeton Gjaka, Spasojë Stefanoviç, Refik Maloku, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kastrati, Nurie Halili, Mentor Hasani, Mentor Ferizi, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Nasuf Aliu, Sylejman Mehulli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Munguan: Mensur Kasumi, Ramadan Parduçi dhe Shkelzen Xhaferi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezentë 32 anëtarë të kuvendit dhe kuorumi është i plotë për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe nënkryetarja znj. Hava Mlinaku-Rruka, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-pasi hapi mbledhjen konstatoi se ka kuorum të mjaftueshëm për mbajtjen dhe marrjen e vendimeve të plotfuqishme, deklaroi se për pikat lidhur me këmbimin e pronës komunale, duhet të hiqen nga rendi i ditës pasi që për të njëjtat nuk i kemi vlerësimet nga ana e Ministrisë së Financave dhe propozoi që të mos procedohen në rendin e ditës për shqyrtim dhe aprovim.

Hava Mlinaku-Rruka, nënkryetare e komunës-pas i përshëndeti gjithë të pranishmit, njoftoi se Kryetari i Komunës gjendet në një udhëtim zyrtar dhe ajo zëvendëson atë sipas detyrës zyrtare. Më tej deklaroi se pikat lidhur me këmbimin e pronës komunale tërhiqen nga rendi i ditës, pasi që për të njëjtat nuk kemi pranuar vlerësimet e tyre nga ana e Ministrisë së Financave.

Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit-pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit në adresimin e saj para kuvendit deklaroi: se edhe sot po shihet papërgjegjësia e Kryetarit të Komunës, ku për disa seanca radhazi ai mungon dhe nuk prezanton para anëtarëve të kuvendit, edhe pse ky kuvend disa herë i ka shtyrë seancat që ai të jetë prezent, kur ai ishte jashtë vendi duke luajtur “rolin e Ministrit të Punëve të Jashtme”, por ne për gati tri vite e gjysmë akoma nuk i dimë përfitimet e komunës nga këto vizita të kryetarit jashtë vendit tonë. Por ky kryetar i komunës kohëve të fundit po shihet si i është kthyer fuqishëm Vushtrrisë por duke zgjedhur që punët në komunë e qytet ti kryej nga dy herë për të njëjtat projekte, siç ka bërë me rrugën “Pandeli Sotiri” e tash njëjtë është edhe me rrugën “Bekim Berisha” ku e kanë shtruar asfaltin e ri e më pas i është kujtuar se nuk i kanë vendosur gypat dhe tani është prishur ajo rrugë edhe pse afati i fundit për përfundimin e këtij projekti ishte 24 tetor 2024, edhe pse kanë kaluar më shumë se gjashtë muaj ky projekt nuk ka përfunduar. Për këtë ajo kërkoj të informohet nga kryetari i komunës se kush merr përgjegjësi për këto dështimet për këto shpenzime shtesë, a janë ndërmarr masa ndaj operatorit ekonomik dhe ndaj mbikëqyrësve të këtij projekti. Rasti tjetër është edhe me tregun kur kuvendit ende nuk i është prezantuar ndonjë projekt, dhe ku zotimi i kryetari ishte që ky treg të bëhet me parking nëntokës duke e vlerësuar si projekt adekuat, por që tani doli që ky projekt të bëhet me dy kate. Pastaj rasti tjetër që konsiderohet si qershia mbi tortë është ai i sheshit të qytetit, ku si duket projekt më i madh i kësaj qeverie do ti ndëshkoj në zgjedhjet lokale që do të mbahen në fund të këtij viti. Ky projekt i sheshit të qytetit i ngritur në stilin e murit kinez, kryetari ka vendosur ta mbuloj me disa lokale, duke e mbyllur segmentin kyç në atë pjesë të rrugës, ku tani është ngushtuar kjo rrugë dhe askush nuk po merret me këtë problem. Kjo nuk është për tu befasuar pasi që kjo qeveri nuk ka qenë në gjendje që për tri vite resht ti rregulloj as mikrofonat në sallën e kuvendit, ku zëri dhe pamjet e seancës së kuvendit janë të tmerrshme për shkak të dëmtimit dhe vjetërsimit të pajisjeve të sallës së kuvendit, në ndërkohë parat e ndara për zyrën e kuvendit janë shpenzuar për udhëtime jashtë vendit, për mëditje dhe dreka zyrtare. Prandaj vlerësoi se qytetarët e Komunës së Vushtrrisë meritojnë më shumë!.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit- pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit në adresimin e tij para kuvendit deklaroi se: me të vërtet cilësia e xhirimeve të kuvendit është për keqardhje, dhe të gjitha diskutimet dhe vendimet që merren në këtë kuvend nuk mund të kumtohen para qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë. Kjo gjendje me kushtet e punës në sallën e kuvendit me shumë gjasë është duke u bërë qëllimisht që të mos dëgjohet zëri opozitar dhe të mbytet transparenca. Tutej për këtë çështje nuk duhet të fajësohet kryesuesja e kuvendit, pasi që ajo ka tentuar disa herë të bëjë rregullimin e kësaj çështje por e cila nuk ka gjetur përkrahjen e kryetari dhe qeverisë komunale. Sa i përket mungesë në seancë të kryetari të komunës, është normale sepse ai do të ikë nga seanca për këta 5 apo 6 muaj mandat sa i ka mbetur sepse ka frik të ballafaqohet, ai do të ikë nga përgjegjësia, nga premtimet ndaj qytetarëve që nuk i ka përmbushur, nga dështimet e tij, nga mos dija dhe mos puna e tij. Tutje shtoj se paramendoni Vushtrria krenohet me trashëgimin e vjetër historike se një ndër qytetet me të vjetra, ndërsa po ajo trashëgimi shkatërrohet nga ana e kësaj qeverie të papërgjegjshme, dhe kjo pikërisht me disa “projekte” të betonimit siç është ai tek Kalaja e Qytetit dhe rruga që po ndërtohet afër Urës së vjetër të Gurit. Kjo të bënë të çuditemi edhe nga partia tjetër LVV-ja, e cila kur bëhet fjalë për disa objekte tjera të parëndësishme në Komunën e Vushtrrisë shembull ish Gjykata Komunale, këta thurin vargje e ngritin lavde për atë objekt të pavlerë për qytetin e Vushtrrisë për të cilin qytetarët tanë kanë vetëm kujtime të këqija, dhe për këtë intervenohet në Ministrinë e Kulturës për ti bllokuar projektet, në ndër kohë nuk intervenohet në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore me rëndësi të veçantë. Në fund tha se krejt këto po ndodhin për shkak të paaftësisë se kësaj qeverie dhe verbërimit të saj nga mania për ta mbajtur pushtetin në

komunë. Më pas ai ngrit çështjen e problemit me avancimet kadrovike në administratën komunale, e cila për bëhet krejtësisht mbi baza partiake pa meritokraci dhe mbi kritere jo profesionale, në këtë kontekst ceku se ka raste të ngritjes së koeficienteve të zyrtareve të posa pranuar në punë, ndërsa zyrtarja ligjore në Drejtorinë e Financave edhe për kundër përvojës së gjatë asaj nuk i rritet koeficienti duke diskriminuar në baza partiake e politike. Në fund deklaroi se frezimi dhe rregullimi i rrugës në dale të qyteti që ka qenë një ndër rrugët më të mira po bëhet vetëm për të ia vendosur kanalizimin një objekti shukatësh privat.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit- pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit në adresimin e tij para kuvendit deklaroi se: dëshiron të jap disa përgjigje që janë me rëndësi të veçantë për qytetaret, por edhe një përgjigje edhe për përfaqësuesin e LDK-së si parti-opozitare i cili tenton që Lëvizjen Vetëvendosje ta vendos në një situatë kinse të mos reagimit qytetar, edhe pse LVV në Vushtrri ka qenë dhe është zëri kryesor opozitar në kuvendin e Komunës së Vushtrrisë dhe gjetiu. Përfaqësuesi i LDK-së çuditet me ne por në fakt këta e çuditin edhe vetveten e tyre. Duke ju kthyer kujtesës jo të largët të praktikës së kuvendit në Vushtrri, LDK si parit sipas tij në thonjëza opozitare, kishte votuar për gllabërimin e pronave publike të Komunës së Vushtrrisë, par më pak se katër muajsh po në këtë mandat e po në këtë kuvend. Dhe posa ky proces kthehet në pikën zero nga MAPL si proces i kundërligjshëm falë LVV-së në Vushtrri, dalin përfaqësuesit e LDK-së dhe tentojnë ti marrin meritat kinse duke sulmuar kryetarin e komunës e në fakt ata ishin bashkëpjesëmarrës në gllabërimin e këtyre pronave publike të komunës. Këto dhe çështje tjera i ka ngritur në mbledhjen e KPF-së, po i ngrit edhe në seancën e kuvendit dhe përherë do ti ngrit para qytetarëve për të mbrojtur interesin e përgjithshëm qytetarë, duke shprehur dyshimin e tij në dëmtimin e zërit nga diskutimi i tij nga tekniku mbikëqyrës i kësaj seance. Në vazhdim shtoj se kryetari i komunës z. Ferit Idrizi, e ka dorëzuar stafetën e tij akoma pa i përfunduar ligjërisht mandati i tij. Ka disa muaj që nuk merr pjesë në seancat e kuvendit, e çështja e mungesësës është ngushtë e lidhur me format e ndryshme të presonit publik e privat që i ka prej partisë së vetë, e sidomos me çështjen e pronave dhe pazaret e mëdha me këto prona, të cila ia kemi ndaluar si opozitë edhe e kemi detyruar të zotohet në foltore të kuvendit se të njëjtat nuk do ti sjellë në kuvend për aprovim. Por edhe sot po shihet se i ka sjellë edhe disa këmbime pronash me disa biznese dhe oligark për interesa të tyre e që janë të lidhur me partinë në pushtet në komunë, por që fatmirësisht i ka tërhequr nga rendi i ditës por që në ndërkohë është ikur nga seanca për të mos u ballafaquar, me këto sekuenca të pakëndshme të keqqeverisjes së tij. Më tej përsërit se kjo është qeverisja më e dobët që e kemi përjetuar ndonjëherë në komunën e Vushtrrisë, ku i gjithë qyteti është shndërruar në kaos dhe pak ka hapësirë për të komentuar këtë gjendej, sepse tashmë të gjithë qytetarët po e shohin dhe ndjenjë çdo ditë keqqeverisjen dhe kaosin që ka shkaktuar kjo qeverisje. Se degradimi, rrëmuja dhe kaosi e ka pllakosur Vushtrrinë këtë e tregon më si miri fakti se tashëm ka filluar edhe shkatërrimi i trashëgimisë kulturore. Kryetari i komunës në kuadër të kompetencave të tij ka për obligim të dal publikisht dhe të njoftoj opinionin publik me të se çfarë po ngjanë me trashëgimin kulturore në Vushtrri me intervenimet e fundit që janë bërë në afërsi të urës së gurit dhe Klasë së Qytetit. Qyteti i Vushtrrisë si qytet i lashtësisë dhe trashëgimisë, ku gjurma e historisë daton shumë herët nga antikitetit duhet të ruhet dhe mbrohet. Për këto të bëma kryetari i komunës ka për obligim të bëjë një sqarim për publikun aty ku vetë ka ndërhyrë, ndërsa aty ku deklaroi se nuk janë investime të qeverisë së tij, duhet ta tregoj autoritetin e vet ndaj një institucioni publik siç është posta, sepse nëse edhe ndaj një institucioni nuk mund të tregoj autoritet atëherë çfarë duhet prituri nga një kryetar i tillë. Ai beton i vendosur ngjitas e ka shëmtuar pamjen e Kalas dhe na ka qitë hije të keq krejt qytetit të Vushtrrisë. Në fund tha se në vend se qeveria dhe ne ta promovojmë trashëgimin

kulturore, ne jemi duke degraduar atë dhe Vushtrria tashmë në aspektet e përgjithshme është bërë një qytet i shëmtuar dhe i pajtueshëm.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit-vlerësoi se çështja e renovimit të ish objektit të gjykatës komunale, ishte ndërmarr sepse për këtë objekt angazhohen jug nostalgjiket që janë duke e qeverisur Kosovën. Tek projekti tek ura e vjetër e gurit, aty ka qenë një hapësirë e mbuluar me mbeturina ndërsa tani ajo është mirë dhe rregullimi i rrugës është gjë me vend për të krijuar kushte të një ambienti më të mirë. Lidhur me problemet në rrugën “Skënderbeu” në Vushtri, kërkoj nga komisioni mbikëqyrës dhe DSHP-ja të sjellë kontratën, sepse menaxhimin e ujërave të zeza e bënë Kompania “Ujësjiellësi”, dhe qytetarët e komunës së Vushtrisë paguajnë qindra mijëra euro dhe kërkoj nga komisioni mbikëqyrës i asaj kontrate të sjellë raport të detajuar sepse shërbimet nuk janë duke u kryer në nivelin e duhur.

Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit- njoftoi se ka pranuar një email nga ana e z. Shkodran Imerja, i cili shkruan se në seancën e fundit anëtarët e kuvendit kanë përdorur një gjuhë jo korrekte në raport me të, por e vërteta është se ne nuk e kemi përkrahur kërkesën e tij në fakt nuk e kemi aprovuar kërkesën e tij për mbështetje financiare. Ne kemi kërkuar që për atë çështje të fokusohemi te historianet tanë lokal. Andaj, lidhur me këtë çështje ai kërkoj të dijë se kush i ka dhënë email-adresat këtij personi me të cilin ne nuk kemi kurrfarë kontakti, sepse mendon se nuk është e drejtë të i jepen emailat e të gjithë përfaqësuesve të kuvendit.

Hava Mlinaku-Rruka, nënkryetare e komunës-sqaroi para kuvendit se kërkesën për pëlqim, për projektin dhe punimet tek ura e gurit e kemi dërguar me kohë. Më tej njoftoj se për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur në QRTK, por edhe në Drejtorinë e Urbanizmit, është dashur të përsëritet e gjithë procedura. Andaj njoftoj se posa ta marrin pëlqimin punimet do të vazhdojnë dhe ai projekt do të përfundojë.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-tha se çështjen e pëlqimit për punimet tek ura e gurit e kishin ngritur në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, se komuna a ka pëlqim nga MKRS-ja, QRTK-ja dhe IKMM-ja, për punimet rreth urës së gurit. Kjo për faktin se është e palogjikshme që në atë rrugë të lëvizin veturat, sepse kështu mund të shkatërrohet ura e gurit. Është e vërtetë se në të kaluarën aty ka ekzistuar rruga vetëm për këmbësor dhe eventualisht për ndonjë kerr. Konkretisht pyeti se deri ku kanë shkuar punimet në atë rrugë dhe mbi bazën e çfarë procedure është duke u punuar kur nuk kemi akoma një pëlqim nga niveli qendror.

Benjamin Shala, drejtor i DSHP-së-sqaroi se punimet afër urës së gurit, kanë të bëjnë në tanësi me rregullimin e një parku dhe fusha rekrative, por edhe me rregullimin e një shëtitoreje aty afër.

Izet Miftari, drejtor i DKRS-së-tha për trashëgimin kulturore nuk ka pranuar kurrfarë pyetje nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe rrjedhimisht nuk mundur të japë përgjigje. Por lidhur me këtë çështje ai e ka njoftuar Drejtorin e Urbanizmit, se ku ka punime afër monumenteve kulturore, duhet të merret paraprakisht pëlqimi nga ana QRTK-së në Mitrovicë. Ai vlerësoi se kur flasim me trashëgimi kulturore të gjithë duhet të angazhohemi në ruajtjen e saj.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-sqaroi se kur bëhet fjalë për urën e gurit jo vetëm afër urës por edhe mbi urë ka pasur kalim të veturave, por këtë gjenerata e reja nuk e mbajë në mend. Pastaj shtoi dhe vlerësoi se aty është duke u zhvilluar një projekt për rekracion dhe një shëtitore që janë projekte shumë të qëlluara. Ai apeloi që mos të marrim bajraktarizëm dhe të flasim duke i penguar projektet në forma të ndryshme.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-bëri të ditur se punimet tek ura e gurit janë ndaluar nga ana e QRTK-së dhe kjo është fakt, ndërsa nëse kjo mohohet, atëherë ai kërkoj komunikimet zyrtare të qeveris komunale me zyrtarët e QRTK-së lidhur me këtë çështje. Lidhur me pronat komunale ai

potençoi se gjysma e grupit kuvendar të LVV-së në Vushtrri kishte votuar pro atyre pronave për ti dhënë në shfrytëzim.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-duke ju referuar parafolësit të tij, shtoi se grupi kuvendar i LVV-së asnjëherë nuk ka votuar kundër interesit të përgjithshëm dhe as për pronat afër urës së gurit. Prandaj nuk është mirë të shërbehemi me të pavërteta sepse qytetari i Vushtrrisë i njeh të gjithë. Po ashtu kërkoj dhe përsëriti për përgjigje nga nënkryetarja e komunës për betonimin që po ndodh afër Kalas së Qytetit.

Hava Mlinaku-Rruka, nënkryetare e komunës-njoftoi se për çështjen e punimeve afër Klasë së Qytetit, do të njoftoheni me shkrim nga ana e Drejtorit të Urbanizmit, për faktin se nuk i ka informatat e plota lidhur me këtë çështje dhe nuk dëshiron të plasoj ndonjë informatë të gabuar apo jo të saktë.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-pyeti se përse po bëhen ndasi, ndaj zyrtarëve civil në administratën e komunës sa i përket ngritjes së koeficienteve duke përmendur rastin konkret të një ish pjesëtare të PDK-së në Vushtrri ndërsa tani ajo ka aderuar në Lëvizjen Vetëvendosje, dhe asaj po i bëhet e pa drejt për shkak të mendimit të saj politikë.

Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-prezantoi para kuvendit pikat shtesë që janë dërguar përmes adresës elektronike që kërkoj që ato të futen në rendin e ditës për shqyrtim.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-lidhur me kërkesën e z. Adrian Shala, arsyetoj dhe kërkoj që kjo pikë të futet në rend të ditës për shqyrtim dhe aprovim pasi që drejtoresha e shkollës në fshatin Pestovë znj. Ferdan Shala është diagnostifikuar me një sëmundje të rëndë, e që kërkon trajtim jashtë vendit me një kosto financiare jashtëzakonisht të lartë rreth 60,000.00 €. Diagnoza e zonjës është caktuar nga Dr. Agim Bregaj, kolegë i yni të cilin e falënderojmë për tretmanin e tij profesionalë dhe human. Lidhur me këtë çështje kërkoj që kjo kërkesë të mbështet nga ana e kuvendit për ndarjen e mjeteve financiare, apo që ndihma të ofrohet edhe përmes një fushate sensibilizuese për ndihmesën e saj në këto rrethana rënduese.

Në vazhdim kuvendit me 25 vota “për” 1 votë “abstenim” aprovoj për inkorporim në rendin pikat sinë vijim: Propozim-vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës nga viti 2024 në vitin 2025. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit me numër të protokollit nr. 18/25 i datës 30.01.2025, lidhur me ndarjen e mjeteve financiare për furnizim me pako ushqimore për zyrtarët e Komunës së Vushtrrisë. Shqyrtimi i kërkesë për ofrimin e mbështetjes financiare për shërim të znj. Ferdane Shala. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për caktimin e lokacionit për ndërtimin e bustit për Dëshmorin Avni Saraçi.

Në fund të debatit, jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me 25 vota “për” 1 votë “abstenim”, aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 27 mars 2025.
2. Raport tremujor për të hyrat dhe shpenzimet e komunës së Vushtrrisë për vitin 2025.
3. Propozim-vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës nga viti 2024 në vitin 2025.

4. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit me numër të protokollit nr. 18/25 i datës 30.01.2025, lidhur me ndarjen e mjeteve financiare për furnizim me pako ushqimore për zyrtarët e Komunës së Vushtrrisë.
5. Shqyrtimi i kërkesë për ofrimin e mbështetjes financiare për shërim të znj. Ferdane Shala.
6. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për caktimin e lokacionit për ndërtimin e bustit për Dëshmorin Avni Saraçi.
7. Pyetje dhe përgjigje.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 27 mars 2025.

Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit-duke ju referuar faqes 13 të procesverbalit, ceku se diskutimi i tij është devijuar dhe nuk është pasqyruar drejt kuptimi i diskutimit të tij. Ai ceku se diskutimi i tij ka dal jashtë konteksti sepse ai nuk ka deklaruar *<shtoj se lidhur me vlerësimin e nxënësve kemi defekte sepse kemi nxjerr kuadro që nuk janë kredibile për të ofruar mësimdhënie cilësore>*, kjo frazë është jashtë kontekstit të diskutimit të tij. Ai kishte kërkuar të ofrohet një raport për përgatitjet profesionale të mësimdhënësve. Ai kërkoj që ose të shënohet ajo që ka deklaruar ose të mos shënohet fare diskutimi i tij.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me 23 vota “për” miratoi Procesverbalin nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 27 mars 2025, me vërejtën dhe ndryshimin e cekur si më lartë.

2. Raport tremujor për të hyrat dhe shpenzimet e komunës së Vushtrrisë për vitin 2025.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-duke ju referuar raportit ceku se disa nga kodet ekonomike janë hequr fare nga raporti, ndërsa nuk kemi shtim të kodit ekonomik që është kërkuar lidhur me drekat zyrtare. Konkretisht pyeti drejtorin e Drejtorisë së Financave se përse është hequr nga raporti kodi për shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit, ai për drekat dhe darkat zyrtare për vitin e kaluar krahasimet dhe për këtë vit. Për këtë tre mujor janë shpenzuar 2370 €, kurse më tej kemi kërkuar sqarime lidhur me shërbimet teknike, se çfarë nënkuptojnë këto shërbime në shumën e shpenzimit të tyre prej 9060 €, për pajisje tjera shuma e shpenzimit 17,955 €, tek avansi me pare të imta shuma 6,480 €. Tek mirëmbajtja dhe riparimi i veturave po ashtu kemi një shumë jashtëzakonisht të lartë të shpenzimeve për të cilën kërkoj sqarime, ndërsa qiraja për automjetet e komunës vetëm për këta muaj është 11,442.024 €. Sa i përket raportit të shpenzimeve kapitale, nuk shihen mirë shifrat por fatkeqësisht kemi shumë projekte që nuk janë realizuar fare dhe nuk dihet arsyeja e këtij dështimi, por për këtë mund ta marrim me mend sepse mjafton të dalim në fshatrat dhe qytetin e Vushtrrisë dhe mund të shohim se si ka vepruar dhe qeverisur qeveria aktuale e komunës së Vushtrrisë, ku e gjitha është shndërruar në një katrahurë.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se raporti që e keni sjell në kuvend ka mospërputhje të tabelave, sepse disa shënime që janë tek tabela: përmbledhja e shpenzimeve sipas kategorive të larta ekonomike nuk përputhen me shënimet për të njëjtën kategori tek tabela e shpenzimeve të investimeve kapitale. Tek tabela përmbledhje në realizimin e investimeve kapitale i kemi 1,618,357.71 ,kurse tek tabela e shpenzimeve kapitale te kolona c (shpenzimet për periudhën 3 mujore) janë 2,125,127,43. Për çka është kjo difference drejtor, a po i kontrollon shënimet e veç po i sjell paushall? Kryetari vazhdimisht po ankohet që nuk po kemi mjete se i ka marre përmbaruesi

por shpenzimet e luksit fare nuk po i zvogëlon, përkundrazi vetëm sa i ka shumëfishuar p.sh kodi 13143 te shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit në këtë periudhë i kemi 2,378.00, kurse vitin e kaluar kemi pasur vetëm 147.00 pastaj te kodi 13820 avancet për udhëtime zyrtare këtë periudhë i kemi 6,488.97 kurse vitin e kaluar kishim 1,006.20. Kemi edhe shume kode ekonomike ku kemi shpenzime janë shumëfish më të larta këtë vit se vitin e kaluar. Por ajo që me beri përshtypje më shumë është kodi 14010 mirembajtja e automjete ku kemi 9,228.40 kur dihet fakti që shumë automjete keni marre me lizing dhe keni paguar 11,442,25 ne kodin 14160 qiraja për automjete.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-vlerësoi se shumë prej çështjeve që u diskutuan këtu, i kemi ngritur edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, për të cilat edhe kemi kërkuar materiale-tabela shitesë për sqarime dhe për bërë transparente këto çështje të natyrës financiare. Këto materiale nuk na janë ofruar dhe kjo lenë dyshime të bazuar se kemi të bëjmë me mos transparencë për sa i përket shpenzimit të parasë publike. Ai ftoj që edhe qytetarët ti shikojnë këto tabela dhe të vihen në dijeni me mënyrën se si shpenzohet paraja publike në Komunën e Vushtrrisë. Tutje shtoj se ka kërkuar sqarime shitesë për kodin ekonomik për drekat zyrtare, sepse të gjithë ne jeni dëshmitar publik, të dhjetëra e qindra drekave për kolektivet e ndryshme të sektorëve të ndryshëm publik të Komunës së Vushtrrisë që kryetari i komunës i ka qarrosë me paratë publike të Komunës së Vushtrrisë, sidomos gjatë muajit të Ramazanit, sepse Ramazani simbolizon vlerat e solidaritetit, por asnjëherë nuk përfaqëson zhvatjen e fondeve publike. Ma parat e komunës jeni bërë shumë dorëlibër duke paguar iftare për kolektivin e arsimit të komunës, për punëtorët e Ndërmarrjes “Përparimi” dhe për punëtorët e administratës së komunës së Vushtrrisë. Asnjë informatë për këto shpenzime të parasë publike, jo transparencë e plotë, dhe shtohet pyetja se çfarë po ndodh me gjithë këto shpenzime dhe nga po shkojnë këto para. Pastaj këto tabela janë kontradiktore në shumë aspekte njëra me tjetrën. Mjafton ta shohim kodin 13140 shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit janë zero në ndërkohë në kodin avans për udhëtime zyrtare janë shpenzuar 6488 €, cila logjik mund ta shpjegoj këtë mospërputhje të numrave, dhe shtrohet pyetja a ka pasur udhëtime jashtë vendi apo jo, a janë shpenzuar këto mjete apo jo cila është përgjigja që duhet ta dinë qytetari i Vushtrrisë. Tutje shtoj se në mbledhjen e KPF-së është kërkuar që në mbledhjen e kuvendit të jenë të pranishme të gjithë drejtorët e drejtorive komunale, pasi që shumë kodet të shpenzimit të buxheti lidhen me drejtoritë e ndryshme komunale dhe ata duhet të jenë të pranishëm për ti arsyetuar këto shpenzime. Në këtë kontekst është dashur të bëhet e ditur për qytetarët dhe kuvendare se si është e mundur që për këtë tre mujor në kodi ekonomik 11460 shpenzime kontraktuese të tjera të shpenzohen prej 700,000.00 € sa kanë qenë në vitin paraprak të rriten këto shpenzime në 1, 715,000 €, cili është sqarimi për këto kod që janë rritur kaq shumë këto shpenzime çfarë ka ndodhur kaq e jashtëzakonshme që janë rritur këto shpenzime për 1 milion euro. Pajisje tjera prej zero në 17,855.00 €. Shumë e dyshimtë është çështja e kontratës së drunjtëve për ngrohej të shkollave që është një shumë e jashtëzakonshme e mjeteve financiare, prej 942,000.00 € që e kishe kundërshtuar LVV-ja në Vushtri, sepse me këtë shumë të mjeteve financiare kishte mundur të ndryshohet i gjithë sistemi i ngrohej nëpër shkolla, ndërsa diferenca e pagesës nga vitit i kaluar për këtë çështje është 80,000.00€. mirëmbajtja e shkollave prej zero në vitin e kaluar ka shkuar në shumën 32,500 €. Shërbimet intelektuale, nga 1700 € sa kanë qenë në periudhën paraprake për këtë periudhë janë rritur në 4607 €, dhe për këtë pyeti se cilët intelektual Komuna e Vushtrrisë është duke i paguar. Tek kodi 13950 regjistrimi i veturave zyrtare për përdhën e njëjtë vitin e kaluar kemi pasur shpenzim në vlerë prej vetëm 105€, ndërsa për këtë vite keni shpenzuar 3160 €, çfarë ka ndodhur me këto shpenzime në vlera kaq të larat, a keni blerë vetura të njëjta apo janë vozitur veturat pa i regjistruar fare? Në fund kërkoj që të ketë më tepër transparencë për sa i takon shpenzimit të parasë publike sepse këto para i takojnë qytetarëve tanë.

Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit-vlerësoi se strukturalisht ky raport nuk është në rregull si p.sh tek përmbledhja e kategorive të larta të shpenzimeve ku janë paraqitur vlerat e përqindjeve të shpenzimit në vlerën 94%. Tek buxheti i planifikuar për vitin 2024 që duhet të jetë viti 2025. Për periudhën që po flasim përqindja e shpenzimit të buxhetit për investime kapitale është 32 % ndërsa për kategorinë subvencione janë shpenzuar 47 %. Ndërsa kolona tjetër thotë se investimet kapitale janë shpenzuar në masën 82 %, kurse subvencionet në masën 92%. Tutje sqaroi se deri në momentin që po flasim niveli i shpenzimit të buxhetit në total është 31.25% e jo 94% siç po proklamohet. Pastaj tek faqja 21 e raportit në mënyrë të vazhdueshme është duke u përsëritur që shumë projektet kapitale janë me vlerë financiare zero, projekte fare të pa filluara.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-në terma të përgjithshëm sqaroi se raportimet tre mujore për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore komunale janë obligime ligjore. Më tej shtoi se nga faza e planifikimit të buxhetit lanësohet edhe plani i rrjedhës së parasë, në baza tre mujore. Ky raport në tërësi pasqyron gjendjen financiare të komunës dhe është tërësisht transparentë pasi që i njëjti dërgohet edhe në Ministrinë e Financave. Buxhetit i planifikuar 9,163.672 €, nga kjo janë realizuar 8,653,268 € shprehur në përqindja e realizimit të buxhetit për këtë periudhë është 94%. Më tej ai sqaroi kodin 11460 shërbimet kontraktuese tjera, ku ceku se nga ky kod bëhen pagesat për N.P.L. “Përparimi” , rrugët e rendit të IV që shtohen me zhavorr, transportit i nxënësve, shërbimet e administratës tatimore e shërbime tjera me çka ka dal edhe një vlerë bukur e madhe e shpenzimit financiar. Lidhur me shpenzimet për vajin, sqaroi se bëhet fjalë për lëndën antifiriz për institucionet publike

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-përsëriti pyetjet e ngritura se përse kemi diskrepanca te tabelat financiare shumat tek kategoritë e larat të shpenzimit respektivisht, në investimet kapitale shuma 1,618.000 €, ndërsa tek investimet kapitale tabela C vlere financiare totale është 2,125.000€, janë vlere të cilat nuk po përputhen dhe duhet ditur se cila vlerë është e saktë. Po ashtu ai pyeti edhe për kodin buxhetor shpenzimet për automjetet zyrtare vlere 9,228 € dhe kodi 14160 qiraja për automjete 11,142 € dhe këtu komuna këto automjete i ka në shfrytëzim me lizing, ku në këtë kuadër përfshihet edhe mirëmbajtja e atij automjeti dhe komuna nuk ka nevojë të paguaj për mirëmbajtjen kur paguhet kontrata e lizingut.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-kërkoj të di se për parat që paguhet për kontratën kolektive sa para paguhet për avokatë, sa për gjyqësor, sa për përmbarueses privat, sepse mësimdhënësve veç iu vjen një shumë e caktuar e mjeteve pa asnjë specifikim. Për këtë pyeti se komuna a dërgon vetëm një shumë të mjeteve ndërsa ajo specifikohet nga ana e avokatit.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-tha se me pëlqeu diskutimi i parafolësit, dhe njoftoj se janë disa raste në shkollën fillore “Migjeni” që iu kanë ardhur p.sh. bashkëshortes së tij vetëm shuma prej 0.35 cent. Për këtë çështje ceku se është fajtor komuna dhe ku kanë mbetur ato para.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-vlerësoi se gjendja hiq më e mirë nuk është as në komunat tjera, dhe shtoi se si ka mundës që për të gjitha këto pagesa nga kontrata kolektive, që të kemi shuma të ndryshme për raste të njëjta dhe më e keqja pse mësimdhënësve nuk ju dërgohet vendimi për ato mjete. Sepse nesër dikush nga zyra e krimeve ekonomike mund ta pyet një mësimdhënës se nga të kanë ardhur këto mjete, ndërsa ai nuk e ka një vendim të gjykatës për ti arsyetuar ato mjete.

Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-njoftoj se para 4 apo 5 viteve ka ndodhur që disa mjete janë kthyer nga mësimdhënësit me paragon dhe nuk dihet ato mjete a janë kthyer në buxhetin e komunës apo jo.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-njoftoi se një kopje i vjen komunës nga përmbaruesi, për secilin mësimdhënës është dosja e kompletuar ku një kopje dërgohet në thesar. Ndërsa thesar e informon

komunë sa është interesi, ku është komplet lista e specifikuar e shpenzimeve, dhe e jep një afat të shkurtër kohorë, organizatës buxhetore që të shikon nëse ato pagesa janë kryer më herët, nëse ka pasur raste të tilla ato janë kthyer në thesarin e shtetit.

Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit-pyeti Drejtorin për Buxhet dhe Financa, sa mjete janë marrë për vendime gjyqësore nga kategoria investime kapitale, dhe nga cilat projekte pasi që siç shihet nga kategoria mallra dhe shërbime janë marrë 352.000.00€, komunalit janë marrë 5500 €, ndërsa nga subvencionet janë marrë 244,000.00€ totali 600,000.00 € janë marrë për vendim gjyqësor. Pyeta është se sa janë marrë nga investimet kapitale dhe nga cilat projekte.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 21 vota “për” 8 vota “kundër” dhe 1 votë “abstenim” aprovoj Raportin tremujor për të hyrat dhe shpenzimet e komunës së Vushtrrisë për vitin 2025.

4. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit me numër të protokollit nr. 18/25 i datës 30.01.2025, lidhur me ndarjen e mjeteve financiare për furnizim me pako ushqimore për zyrtarët e Komunës së Vushtrrisë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 28 vota “për” 1 votë “kundër” dhe 1 votë “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi i kuvendit Nr.59/25 i datës 27.03.2025 për **bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025**, nga të hyrat e bartura në kategoritë si në vijim:

1.1 Ndryshimi bëhet te kategoria Mallra dhe shërbimet nga shuma **78,991.29** bëhet **77,200.29 €**, (vlera financiare e ndryshuar është **1,791.00 €**).

1.2 Investime kapitale.....930,772.00 €

Totali i mjeteve të bartura.....1,007,972.29 €

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për shpenzimet operationale dhe tabela e shpenzimeve kapitale, të cilat mbesin të pandryshuara, përjashtuar ndryshimin në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve të cekura si në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

4. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit me numër të protokollit nr. 18/25 i datës 30.01.2025, lidhur me ndarjen e mjeteve financiare për furnizim me pako ushqimore për zyrtarët e Komunës së Vushtrrisë.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se këtë propozim-vendim nuk do ta përkrahim, dhe arsyeja është se dëshirojmë që ky vendim të jetë në fuqi, sepse ne iu kemi tërhequr vërejtjen edhe atëherë

se jeni duke vepruar kundërligjshëm kur e keni marrë këtë vendim, por në kohën kur është aprovuar ky vendim në kohë të fushatës është bërë garë se cili subjekt po jetë më dorëlibër në ofrimin e mjeteve financiare për zyrtarët e komunës për fushatë elektorale.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se grupi kuvendar i LVV-së e kishte kundërshtuar këtë vendim jo për faktin se solidaritetit për faktin e ligjshmërisë së këtij vendimi dhe e kemi konsideruar me karakter elektoral sepse edhe i njëjti është marrë shumë larg festës së Bajramit për diçka që do bëhet për Festën e Bajramit. Prandaj askush nuk mundë këtui të luaj rolin e opozitarit duke tentuar të na shet moral, kur dihet fakti se LDK në Vushtrri gjithëherë kur ka pasur nevojë kanë votuar pro qeverisjes Idrizi.

Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-sqaroi se ky vendim ka qenë një përpjekje nga ana e kuvendit për të iu dalë në ndihmë zyrtarëve të komunës, me rastin e Fitër Bajramit, për shkak të gjendje me paga të ulëta dhe rëndimit të shportës familjare për shkak të inflacionit dhe assesi nuk ka pasur karakter elektoral. Por edhe përkundër këtyre përpjekjeve ky vendim është kthyer si paligjshëm dhe i pazbatueshëm.

Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-tha se vullneti i të gjithë neve ka qenë që ti ndihmojmë zyrtarëve publik me këtë vendim, por që ka dalë që ky vendim proceduralisht nuk ka qenë në rregull. Për më tepër ky vendim mbetet në fuqi dhe sindikata e administratës së komunës të njëjtin mund ta dorëzojë në gjykatë për ta realizuar të drejtat e tyre.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 12 vota “për” 17 votë “kundër” dhe 1 votë “abstenim” nuk e aprovoj Propozim-vendimin për shfuqizimin e vendimit me numër të protokollit nr. 18/25 i datës 30.01.2025, lidhur me ndarjen e mjeteve financiare për furnizim me pako ushqimore për zyrtarët e Komunës së Vushtrrisë.

5. Shqyrtimi i kërkesë për ofrimin e mbështetjes financiare për shërim të znj. Ferdane Shala.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit-paraqiti një sqarim të zgjeruar lidhur me gjendjen shëndetësore të parashtrueses së kërkesës, ku njoftoj se ai ka marrë pjesë në përcaktimin e anamnezës së pacientës, dhe bëri të ditur se kemi të bëjmë me një diagnozë specifike dhe tepër të rëndë, që donë trajnim specifik jashtë vendit. Ai potencoi se bëhet fjalë për një trajnim mjekësor që kërkon një kosto jashtëzakonisht të kushtueshëm në vlerë prej 60,000.00 €. Prandaj kërkoj nga gjithë anëtarë e kuvendit që kjo kërkesë për mbështetje financiare të përkrahët në mënyrë unanime nga të gjithë siç është përcaktuar në kërkesë.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-deklaroi se ndjejnë dhembje për gjendjen shëndetësore të pacientës-drejtoreshë së shkollës fillore në fshatin Pestovë. Duke ditur se kemi të bëjmë me një diagnozë të rëndë, znj. Ferdan Shala i urojmë shërim të shpejt dhe të plotë. Pasi që kemi të bëjmë me një sëmundje që kërkon një kosto të lartë financiare, njoftoj se këtë kërkesë do ta përkrahin dhe kërkoj që e njëjta të votohet unanimitë nga të gjithë.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-sqaroi se kjo shumë e mjeteve financiare duhet të ndahet nga kategoria subvencione dhe transfere, kodi 730 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 29 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim znj. Ferdane Shala, nga fshati Stanoc i Epërm i ndahen mjete financiare në shumë prej dhjetë mijë euro (10,000.00 €), ndihmë financiare për shërim.

2. Mjetet financiare të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Vushtrrisë, kategoria subvencione dhe transfere, kodi 730 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra e Kryetarit të Komunës si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

6. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për caktimin e lokacionit për ndërtimin e bustit për Dëshmorin Avni Saraçi.

Hava Mlinaku-Rruka, nënkryetare e komunës-pasi sqaroi propozim-vendimin në fjalë, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e bustit për Dëshmorin Avni Saraçi, në parcelën kadastrale P-700202016-00001-1, pronë e Komunës së Vushtrrisë, njoftoi se në konsultim me Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, është hedhur propozimi që në kuadër të këtij vendimi të jetë edhe opsioni i dytë që ky bust të vendoset në parcelën P-04092K-0, kjo për faktin se që kjo çështje të mos sjellët sërish në kuvend për aprovim dhe të hapen diskutime tjera të reja. Pas aprovimit të këtij vendim, më tej Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë si dhe Drejtoria për Urbanizëm do të kujdesen për zhvillimin e mëtejshëm të proceduarave, dhe ceku se në të dyja varantet apo opsionet sipërfaqja për vendosjen e këtij busti do të jetë e njëjtë prej 65 m².

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se pajtohet me diktimin e nënkryetares së Komunës, dhe shtoj se nëse përcaktohem vetëm për parcelën kadastrale P-700202016-00001-1, në këtë variant duhet të merret leja nga ana e QRTK-së, dhe pikërisht për këtë është i pajtimt që të shkohet me votimin e dy opsioneve. Ai apeloj që për aprovimin e këtij propozim-vendim të jemi unik të gjithë sepse po bëhet fjalë për dëshmorë.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se kjo çështje është vërtetë sensitive, që kërkon një dakordim të plotë mes të gjithëve sepse po bëhet fjalë për nderimin e një dëshmori të Kombit. Tutje shtoj se grupi kuvendar i LVV-së shpreh lavdi e nderim për dëshmorin e kombit, duke vlerësuar se janë plotësisht dakord që ky bust për këtë dëshmor të ngritët pikërisht në vendin ku ka rënë dëshmori e jo në parcela apo lokalitete tjera alternative. Mandej ceku se duhet të jemi unik dhe koheziv e bashkëpunues të gjitha grupet kuvendare për këtë çështje duke bërë një zgjidhje të duhur që edhe e nderojmë dëshmorin, por edhe nuk shkaktojmë telashe tjera juridike lidhur me kalimin e filtrave të ligjshmërisë së këtij vendimi. Juridikisht nuk e di se sa mund të mbijetoj një vendim i cili i cakton dy çështje apo lokacione të ndryshme për të njëjtën çështje dhe a mund ti kaloj filtrat juridik si e tillë. Pastaj shtoj dhe konsideroj se ata mendojnë që askush duke përshtirë edhe QRTK nuk duhet të pengoj vendosjen e busteve për dëshmorët e kombit në vendin e tyre të rënies. Pra aty ku është derdhur gjaku aty i takon ngritja e shtatores së dëshmorit sepse kjo është pjesë e historisë po aq sa është historike ura e gurit, po aq do të jetë historike rënia e një dëshmori në zemër të Qytetit të Vushtrrisë për çlirim e liri, dhe mendon se asgjë nuk ka të keqe të vendoset statuja aty ku ka rënë dëshmori, sepse edhe ashtu ky dëshmorë i takon gjeografikisht Artakollit, dhe hyrja e çdo banori të Artakollit është nga ajo pjesë që do jetë një simbolikë e respektuar, që në hyrje të qytetit ia kujton sakrificën e një dëshmori, që ka zhvilluar betejën aty për çlirim. Prandaj në

fund deklaroi se grupi kuvendar i LVV-së e mbështet kërkesën e familjes së dëshmorit për vendosjen e këtij busti në vendin e rënies, sepse e dinë që edhe të tjerët kanë kërkesa të mundshme për faktin se dëshmori ka rënë heroikisht në atë vend, sepse edhe familja po e kërkon të njëjtën gjë vendosjen e bustit në vendin e altari të sakrificë për çlirim e liri.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-tha se nëse veprohet me dy opsionet për lokacione, po e bëjmë një gabim ligjor, sepse në ligje dhe vendim nuk mund të ketë alternativë ose/ose, por duhet të përcaktohem saktë për njërin nga opsionet. Tutje shtoj se nëse dëshirojmë ti mbrojmë vlerat e luftës dhe dëshmorët e kombit, nuk është në rregull që lapidaret e tyre të dërgohen prapa objekteve tjera njëfarë forme të fshehën këto monumente nëpër skuta të caktuara sepse kështu nuk i nderojmë dëshmorët. Prandaj nëse po duam ti nderojmë dëshmoret ata duhet vendosur mu në ballë aty ku edhe kanë rënë në altari e lirisë dhe këtë bust duhet vendosur në parcelën dhe lokacionin ku është ra dëshmori Avni Saraçi.

Hava Mlinaku-Rruka, nënkryetare e komunës-tha se meqë ka dilema që ky vendim nuk mund të aprovohet në mënyrë opsionale, atëherë propozojmë që ky lokacion të vendoset në parcelën P-04092K-0.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se ka dilema juridike nëse vendim do aprovohej në formë opsionale siç u propozua. Por meqë të gjithë jeni pro kësaj çështje që të ngritët ky lapidar, propozoj të merret një pauzë prej 15 minutave që të diskutohet mes grupeve kuvendare kjo çështje me tone jo polemizuese por në frymën unifikuuese dhe të bashkëpunimit.

Basri Menxhiqi, anëtar i kuvendit-tha se kur bahet fjalë për dëshmorët, në grupin kuvendar të PDK-së nuk ka kompromis sepse të gjithë jemi për dëshmorët. Ai vlerësoi se aty ku është vullneti i familjes për ta vendosur këtë bust, aty ne si grup do të jemi për ta aprovuar. Kërkoj të merret një pauzë prej 15 minutave për konsultim mes grupeve kuvendare.

Në vazhdim kuvendit mori një pauzë prej 10 minutave për tu konsultuar mes grupeve kuvendare lidhur me çështjen e propozim –vendimit për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për caktimin e lokacionit për ndërtimin e bustit për Dëshmorin Avni Saraçi.

Hava Mlinaku-Rruka, nënkryetare e komunës-deklaroi se pas konsultimeve që patën mes grupeve kuvendare, u nxjerr konkluzioni që fillimisht të votohet me votim të hapur për çështjen se a jemi që në votim të fshehët të hedhet propozim që ky bust të vendoset në parcelën P-700202016-00001-1, apo që vendim të aprovohet me opsione edhe në parcelën P-04092K-0.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-deklaroi se ai kërkon që të hedhet në votim propozimi i shkruar ashtu siç ka ardhur nga ana e kryetarit të komunës që ky lokacion të vendoset në parcelën kadastrale P-700202016-00001-1, sepse ky është edhe vendi i rënies së dëshmorit Avni Saraçi. Ai propozoi që kjo të dal në votim të hapur dhe nëse ky propozim nëse kalon atëherë propozimi i dytë me opsione fare nuk ka nevojë të dal në votim.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-deklaroi se cilindo propozim që e qitin në votim grupi kuvendar i LDK-së është pro sepse dëshiron që ky propozim për ngritje e këtij busti për dëshmorin Avni Saraçi të jetësohet.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-njoftoi se edhe pse e patëm një takim me shëfave të grupeve kuvendare, prapëseprapë nuk arritëm të gjejmë një pajtueshmëri, dhe në këtë rast deklaroi se i grup kuvendar i LVV-së e mbështesin propozimin që ky bust të vendoset në parcelën P-700202016-00001-1, dhe këtë e mbështesim me plotë vullnet dhe me plotë zemër, për faktin se aty është vendi i rënies së dëshmorit Avni Saraçi. Po ai vend është vendi ku kanë qëndruar patrullat e ish policisë kriminale serbe, ku i kanë pritur banorët e rajonit të Artakollit për ti rrahur dhe maltretuar.

Dëshmori aty e ka bërë sakrificën dhe altarin e lirisë, asgjë dhe askënd të sinqertë në këtë vend nuk e pengon vendosja atij busti në atë vend. Tutje për të mos dashur të polemizojë është po ky kuvend në po këtë përbërje që për ato prona ka vendosur që ato prona të jepen në shfrytëzim për krejt diçka tjetër.

Edona Gashi, anëtare e kuvendit-kërkoj që të hedhet në votim propozim dhe mos të zgjatet debatet pa fije sensi dhe të përfundohet kjo çështje.

Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-në rekapitullimin e debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës konstatoj se fillimisht po votojmë me votim të hapur, për dy propozimet që më pas do të votojmë me votim të fshehtë dhe atë që busti për dëshmorin e kombit të vendoset në parcelën kadastrale P-700202016-00001-1, si dhe për propozim me opsion që lokacioni të caktohet edhe në parcelën kadastrale P-04092K-0.

Në vazhdim kryesuesja e kuvendit e hodhi në votim propozimin e shkruar që busti për dëshmorin e kombit Avni Saraçi të vendoset në parcelën kadastrale P-700202016-00001-1, kuvendi pas votimit me 28 vota “për” sa edhe ishin të pranishëm në sallën e mbledhje u vendos që ky propozim të futet në votim të fshehtë.

Kuvendi pas votimi me vota “unanime” aprovoj themelimin e Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit të fshehtë lidhur me propozim-vendimin për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për caktimin e lokacionit për ndërtimin e bustit për Dëshmorin Avni Saraçi, në parcelën kadastrale P-700202016-00001-1, në përbërjen si në vijim:

Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit PDK;
Edona Gashi, anëtare e kuvendit LDK;
Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit LVV.

Kryesuesja e kuvendit konstatoj se në sallën e mbledhjes janë të pranishëm 28 anëtarë të kuvendit kuorum i mjaftueshëm për marrjen e vendimit të plotfuqishëm në ç’ rast autorizoj komisionin për fillimin e procesit për votimin e fshehtë.

Pas përfundimit të procesit të votimit të fshehtë dhe numërimit të votave kryesuesja e kuvendit konstatoj se 28 vota janë <pro> sa edhe ishin të pranishëm në sallën e mbledhjes, andaj në bazë të këtij votim si duke u bazuar në dispozitat e Statutit të Komunës së Vushtrrisë u vendos me sa vijon:

- 1. Me këtë vendim miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e bustit për dëshmorin Avni Saraçi, në sipërfaqe prej 65 m², pjesë nga parcela P-700202016-00001-1, pronë e Komunës së Vushtrrisë.**
- 2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.**
- 3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: kërkesa me shkrim, projekti për ndërtimin e bustit, lista poseduese e pronës dhe kopja e planit.**
- 4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të**

Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në ora 13:25

Bastri Duraku

Procesmbajtës

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës – Vushtrri

Propozues: kryetari i Komunës z. Ferit Idrizi

Hartues: Komisioni Komunal për Mirënjohje dhe Dekorata:

1. Izet Miftari

2. Albanez Tahiraj

3. Medina Bunjaku

4. Blerim Ibrahim

5. Isak Hyseni

Tema: Propozim-vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 7 të Rregullores 01Nr.209/20 e datës 29.10.2020 për Dhënie e Dekoratave, nenin 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë: 2025, merr këtë:

VENDIM
PËR DHËNIEN E ÇMIMIT “EMBLEMA E VUSHTRRISË”

1. Me këtë vendim, më datë 17 QERSHOR, me rastin e ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, me çmimin “Emblema e Vushtrrisë”, nderohen z.Dibran Perçuku dhe z.Arsim Gërxhaliu, për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare.
2. Dorëzimi i çmimeve do të bëhet nga Kryetari i Komunës, më 17 qershor 2025, me rastin e Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

Arsyetim

Duke e çmuar shumë kontributin e z.Dibran Perçukut dhe z.Arsim Gërgjaliut në çështjen kombëtare, i propozojmë Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë që t'u ndahen çmimi "Emblema e Vushtrrisë".

Më poshtë është e bashkangjitur nga një biografi e shkurtër për personalitetet në fjalë.

DIBRAN PERÇUKU u lindi më 3 korrik 1949 në Ceceli. Klasat e ulëta të fillores i kreu në vendlindje, klasën e V në Samadrexhë, ndërsa klasat VI, VII dhe të VIII në Maxhunaj, gjimnazin në Vushtri, ndërsa Shkollën e Lartë Pedagogjike, Dega e Matematikës në Prishtinë.

Ka punuar si mësimdhënës i matematikës, ka qenë drejtor shkolle, aktivist kombëtar i viteve '90, ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që në ditët e para të fillimi të luftës. Pas çlirimit, ishte një kohë drejtor i shkollës fillore "Ali Kelmendi".

Pas luftës, përkatësisht prej datës 20.9.1999 deri më 12.4.2003 punoi në Trupën Mbrojtëse të Kosovës (TMK) në Zonën e IV në Mitrovicë, nga 13.4.2003 – 28.2.2006 në Shtabin e Përgjithshëm të TMK-së në Prishtinë, ndërsa prej 1 .3. 2006 deri 8. 1 .2008 në ZK të TMK-së në Prishtinë me gradën e nënkolonelit.

Gjatë viteve 2008 – 2011 ka qenë drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike në komunën në Vushtrrisë, ndërsa në vitet 2011 – 2017, ka qenë nënkryetar i komunës së Vushtrrisë.

Për punët cilësore, me profesionalizëm dhe përgjegjësi të lartë që ka kryer, është nderuar me shumë dekorata, mirënjohjeje, lëvdata dhe falënderime.

ARSIM GËRXHALIU

I lindur ne Vushtri me 27.06.1963.

Shkollën e fillore e filloi ne Vushtri, pasi kreu klasën e parë, u shpërngul ne Prishtine ku edhe vazhdoi shkollimin.

Ka diplomuar ne Fakultetin e Mjekësisë ne Prishtine. Magjistroi ne Shkencat Mjekësore , PhD candidat.

Specializimin nga Mjekësia Ligjore e kreu ne Tirane – Fakulteti i Mjekësisë , si dhe Specializimin me standarde Europeane ne Universitetin e COIMBRA ne Portugali.

Kreu trajnime profesionale nga lemia e Mjekësisë Ligjore ne SHBA (Armed Forces Institute of Forensic Pathology), Britani (Bournemouth University), Gjermani - Ependorf University ...etj. I njëjti ka shume publikime shkencore dhe pjesëmarrës në shumë kongrese dhe konferenca shkencore në botë.

Mësimdhënës ne UBT – nga lënda e Mjekësisë Ligjore ,

Ka qenë drejtor i Institutit te Mjekësisë Ligjore 15 vite. Për 23 vite ishte pjese e Komisionit

Qeveritar për persona te zhdukur , udhëheqës i engrupes profesionale – dhe gjate kësaj kohe udhëtoi rreth 440 herë ne Serbi për te kërkuar dhe sjellë eshtrat e popullit tone te varrosura neper varrezat ne Batajnicë, Petrovo Sello, Peruqaci, Rudnice, Kizhevak, Shtaval etj, Punoi ne mbi 2500 vende te dyshuara si varreza ne Kosove.

Për punën e madhe që ka bërë ka marrë shumë dekorata e mirënjohje. Një nga çmimet më të lartat është dekorata "Kryqi nderit të argjendtë" nga shteti gjerman.

Izet Miftari

Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës – Vushtrri

Propozues: kryetari i Komunës z. Ferit Idrizi

Hartues: Komisioni Komunal për Mirënjohje dhe Dekorata:

1. Izet Miftari

2. Alban Tahiraj

3. Medina Bunjaku

4. Blerim Ibrahim

5. Isak Hyseni

Tema: Propozim-vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 8 të Rregullores 01Nr.209/20 e datës 29.10.2020 për Dhënie dhe Dekorata, nenin 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë: _____
2025, merr këtë:

VENDIM

PËR DHËNIEN E ÇMIMIT “HASAN PRISHTINA”

1. Me këtë vendim, me rastin e organizimit të manifestimit “Ditët e Hasan Prishtinës”, me çmimin “Hasan Prishtina“, nderohen vëllezërit Sabri, Selatin, dhe Bedri Novosella, për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare.
2. Dorëzimi i çmimit do të bëhet nga Kryetari i Komunës, me rastin e mbajtjes së manifestimit “Ditët e Hasan Prishtinës”.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

Arsyetim

Duke e çmuar shumë kontributin e vëllezërve Sabri, Selatin dhe Bedri Novosella në çështjen kombëtare, i propozojmë Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë që t'u ndahet çmimi "Hasan Prishtina".

Më poshtë është e bashkangjitur një biografi për personalitetet në fjalë.

Vëllezërit Sabri, Selatin dhe Bedri Novosella u lindën në Vushtri: Sabriu në vitin 1943, Selatini në vitin 1945 dhe Bedriu në vitin 1947. Familja Novosella kaloi nga Vushtrria në Prishtinë, në vitin 1953. Prindërit Ismaili dhe Nailja i rritnin, edukonin dhe shkollonin 4 bijtë e tyre - Qazimin, Sabriun, Selatinin, Bedriun dhe tri vajzat-Igballen, Magbulën dhe Meleqen, si shumica e shqiptarëve në atë kohë, në kushte të robërisë jugosllave. Kështu ndodhi deri më 8 qershor 1964, kur u burgos Sabriu së bashku e Adem Demaçin dhe rreth 300 veprimtarë të organizatës atdhetare Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, (LRBSH), të cilën e kishte themeluar Adem Demaçi, Fazli Greiçevci etj., në Prishtinë në shtator të vitit 1963. Sabriu me Adem Demaçin dhe 12 anëtarë të LRBSH-së, u gjykuan në Gjyqin e Qarkut të Prishtinës, në shtator të vitit 1964 Adem Demaçi u dënua me 15 vjet burg të rëndë, dhe u dërgua në Burgun e Nishit, ndërsa Sabri Novosella u dënua me 9 vjet burg të rëndë dhe u dërgua në Burgun e Goli Otokut.

Po në vitin 1964 u dënua Selatin Novosela nga gjykata për të mitur dhe u përjashtua nga shkolla Normale në Prishtinë, sepse, së bashku me anëtarët e LRBSH-së që kishin mbetur të paburgosur, kishin ngritur flamuj kombëtar, atëherë rreptësisht të ndaluar, dhe kishin shkrua parrullat në Vushtri "Duem liri!" dhe "Rrnoftë Shqipnia!".

Deri sa Sabriu ishte në vuajtje të dënimit në Burgun e Goli Otokut Selatini me shokë kishin filluar organizimin e demonstratave të vitit 1968. Në demonstratat e këtij viti, që zhvilluan gjithandej në qytetet e Kosovës, në demonstratat e 27 nëntorit dhanë kontribut të dalluar vëllezërit Novosella: Sabriu (i cili ndërkohë ishte liruar nga Burgu)-në cilësinë e këshilltarit, së bashku edhe me veteranin e Lëvizjes Kombëtare, Metush Krasniqin, se çka do të duhej të kërkohej në demonstratat e ardhëshme; nga ana tjetër, Selatini ishte në mesin e organizatorëve kryesor në Prishtinë, ndërsa Bedriu u dallua si organizator në Fakultetin Ekonomik të Prishtinës, ku studioje. Bedriu u dënua me dënim për kundërvajtje, ndërsa Selatini dhe 8 shokët e tij u dënua me nga 5 vite burg, prej të cilave i vuajti 4 vite në Burgun e Pozharevcit së bashku me Adem Demaçin dhe veteranët e tjerë që po mbanin burgjet e gjata për lirinë e Kosovës.

Në vitin 1975 do të burgoset, Selatini për herën e tretë, kësaj rradhe me Adem Demaçin dhe 17 bashkëveprimtarë, si anëtarë të organizatës "Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës". Adem Demaçi, përsëri do të gjykohej me dënim maksimal 15 vjet burg, ndërsa Selatini 7 vjet. Në këtë proces politik ishin të përfshirë edhe atdhetarët-Rexhep Mala, Isa Kastrati, Osman Dumoshi etj.

Deri sa Selatini po e vuante dënimin në Burgun Qëndror në Beogradit, Sabriu së bashku me Matush Krasniqin, Shefqet Jasharin, Jusuf Gërvallën etj, pak muaj pas përfundim të gjykimin të Adem Demaçit me shokë, në vitin 1977, themelojnë organizatën atdhetare "Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve Tjera Shqiptare në Jugosllavi." Pas përpilimit të Programit të kësaj organizate dhe pas formimit të disa Degëve gjithandej Kosovës, Sabriu dhe Jusufi, detyrohen të largohen nga Kosova, Sabriu në Shqipëri dhe pastaj në Turqi e më vonë në Suedi, ndërsa Jusufi në Gjermani.

Zgjerimi i radhëve të anëtarëve të shumë organizatave kishte shtruar para Lëvizjes Çlirimtare të Kosovës, si imperativ të kohës, bashkimin e të gjitha organizatave në një formacion

të vetëm, me një një Program politik dhe një udhëheqësi unike. Si rezultat i këtyre përpjekjeve u mbajt takimi në Adapazar në Turqi ku marrin pjesë: Sabri Novosella dhe Bardhosh Gërvalla, si përfaqësues të organizatës Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve Tjera Shqiptare në Jugosllave; Kadri Zeka si përfaqësues i Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës dhe Bujar Hoxha-konsull i Shqipërisë në Turqi. Ndonëse të gjithë kishin shprehur gatishmërinë që organizatat në fjalë, të formonin një organizatë unike, me qëllim që më vonë mund t'iu bashkoheshin edhe organizatat tjera, marrëveshja nuk u arrit. Takimi i dytë për bashkimin e organizatave atdhetare u mbajtët më 17 shkurt 1982, kur u bashkuan Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve Tjera Shqiptare në Jugosllavi, e përfaqësuar nga Sabri Novosella dhe e Partisë Komuniste Marksiste-Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi, e cila përfaqësohej nga Abdullah Prapashtica dhe Osman Osmani, si dhe përfaqësuesi i Shqipërisë në Turqi, profesor Bujar Hoxha. Organizata e themeluar u quajt "Lëvizja Popullore për Republikën Shqiptare në Jugosllavi", duke u theksuar, në një pikë të Marrëveshje për bashkim, se kjo Marrëveshje do të jetë jo e plotë nëse nuk i bashkohet edhe Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës, e cila pas disa muajsh do t'i bashkohet këtij subjekti të formuar.

Burgjet e Serbisë dhe Jugosllavisë, prej vitit 1964 deri në vitin 1999, ishin shndërruar në shtëpi të dytë për familjen Novosella. Kështu, në vitin 1981, Selatini burgoset për herën e katërt dhe mbahet në të ashtuquajturin në "izolim", për disa muaj së bashku edhe me rreth 400 atdhetarë tjera, kryeshisht ish-të burgosur politikë. Nërsa Iliri i mitur, djali i madh i Sabriut, në vitin 1982, pse kishte shkruar parulla dhe shpërndar afishe në Prishtinë ku ishte kërkuar Republika e Kosovës, deri sa Sabriu ishte në Turqi, dënohet me 18 muj burg për të mitur. Sikur të mos mjaftonin të gjitha këto arrestime në Familjen Novosella, burgoset Bedriu për herën e dytë, në vitin 1989, pas marrjes të asaj gjysmë autonomie që kishte Kosova. Bedriu, së bashku edhe me rreth 250 intelektualë të njohur: anëtarë të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, drejtor të firmave dhe personalitete tjera, dërgohen në burgjet hetuese në Leskovc dhe Vranjë ku torturohen mizorisht nga policia dhe UDB-u Millosheviqit.

Pra, vëllazërit Sabri, Selatin dhe Bedri Novosella si dhe djali i Sabriut, Iliri, për angazhimet e tyre të pandërprera në rrugën bërjes së Lirisë së Kosovës, prej vitit 1964 deri në çlirimin e saj, u burgosën 9 herë nga pushteti komunist dhe çetnik i Serbisë dhe Jugosllavisë, duke i vuajtur dënimet në burgjet e Prishtinës, të Mitrovicës, të Prizrenit, të Pejës, të Gjilanit, të Nishit, të Pozharvcit, të Goli Otokut, të Beogradit dhe të Leskovcit!

Pas çlirimit të Kosovës, vëllazërit Novosella, secili në fusha të ndryshme, treguan suksese të jashtëzakonshme: Sabriu si ndërtimtar i dalluar, pronar i banjës më të madhe në rajon "NËNA NAILE" me 2.000 shtretër, si dhe duke shkruar rreth 20 libra publicistike. Selatini, fillimisht, ishte nënkryetar i Komunës së Prishtinës si dhe njëri nga studiuesit dhe autorët më të dalluar në Kosovë, sidomos publicistikën historike, duke botuar, deri sot, rreth 40 vepra, në mesin e tyre 15 vepra kushtuar Heroit të Kosovës, Nderit të Kombit dhe fituesit të Çmimit SAHAROV të Parlamentit Evropian-Adem Demaçit. Ndërsa Bedriu, si ekspert i ekonomisë dhe afarist njohur, ka arritur të ndërtoj rreth 5.000 banesa, duke u bërë ndërtimtari më i njohur jo vetëm në Prishtinë por edhe më gjërë. Poashtu, Bedriu ka Fabrikën e Barnave "TREFARM" si më të madhën në rajon.

Izet Miftari

Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës – Vushtrri

Propozues: kryetari i Komunës z. Ferit Idrizi

Hartues: Komisioni Komunal për Mirënjohje dhe Dekorata:

1. Izet Miftari

2. Albanez Tahiraj

3. Medina Bunjaku

4. Blerim Ibrahim

5. Isak Hyseni

Tema: Propozim-vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 14 të Rregullores 01Nr.209/20 e datës 29.10.2020 për Dhënie e Dekoratave, nenin 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë: _____
2025, merr këtë:

**VENDIM
PËR DHËNIEN E ÇMIMIT “PENA E ARTË”**

1. Me këtë vendim, më datë 17 QERSHOR, me rastin e ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, me çmimin “Pena e artë”, nderohet Prof.asoc.dr.Mentor Hasani, për kontributin e dhënë në nivel kombëtar e ndërkombëtar.
2. Dorëzimi i çmimeve do të bëhet nga Kryetari i Komunës, më 17 qershor 2025, me rastin e Ditës së çlirimit të Vushtrrisë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

Arsyetim

Duke e çmuar shumë kontributin në nivel kombëtar e ndërkombëtar të Prof.asoc.dr.Mentor Hasani, i propozojmë Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë që t'i ndahet çmimi “Pena e artë”.

Më poshtë është e bashkangjitur nga një biografi e shkurtër për personalitetet në fjalë.

Mentor Hasani, i lindur më 23 nëntor 1985 në Vushtri, është profesor universitar dhe udhëheqës i Departamentit të Historisë në Universitetin e Prishtinës – një nga departamentet më të vjetra dhe më me renome akademike në vend. Ai është autor i një monografie shkencore dhe ka një krijimtari të pasur me punime të bazuara në hulumtime arkivore, të cilat kanë ndikuar në ndriçimin e faqeve të rëndësishme të historisë shqiptare, si dhe në përparimin e diskursit historik bashkëkohor. Aktualisht është në proces të përfundimit të monografisë me rëndësi të veçantë “Vushtrria në dokumente osmane”, e cila pritet të sjellë të dhëna të reja e të vjera për historinë lokale dhe kombëtare.

Veprimtaria e tij shkencore është shtrirë përtej mureve të universitetit. Prej marrjes së drejtimit të departamentit, Prof. Hasani ka organizuar mbi tetë aktivitete akademike dhe kulturore në Vushtri – më shumë se në çdo periudhë tjetër – duke sjellë në këtë qytet akademikë, studiues e intelektualë të njohur nga të gjitha trevat shqiptare. Ai ka zhvilluar ekspozita me karakter historik e edukativ, kushtuar figurave kombëtare si Hasan Prishtina dhe Azem c Shote Galica, duke e kthyer Vushtrrinë në një qendër të rëndësishme të kujtesës kombëtare dhe të promovimit të trashëgimisë sonë historike.

Prof. Hasani ka dhënë gjithashtu një kontribut të veçantë në realizimin e dokumentarit “Gjurmë Shqiptare” kushtuar Masakrës së Studimes, duke ndikuar në sensibilizimin e publikut dhe në përfshirjen e kësaj ngjarjeje në kujtesën historike kolektive.

Për kontributet e tij në fushën akademike, edukative dhe humanitare, Prof. Hasani është nderuar me titullin “Ambasador i Paqes” nga Federata Universale e Paqes, si dhe me një sërë mirënjohjesh të tjera institucionale nga universitete, komuna, shoqata kulturore dhe organizata të ndryshme që vlerësojnë punën dhe përkushtimin e tij profesional.

Izet Miftari



Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport




Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Për Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë

Propozues dhe hartues: Komitetit për Politikë dhe Financa kryesuesja e kuvendit dhe KPF-së znj. Melihate Basholli-Latifi 

Tema Propozim-vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenin 19, paragrafi 1, pika 1.4 të Statutit të Komunës, nenit 9 të Rregullores Nr.209/20 për Dhënien e Dekoratave të datës 29.10.2020, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 2025, merr këtë:

VENDIM

PËR NDARJEN E ÇMIMIT "KRENARIA E SPORTIT TË VUSHTRRISE"

1. Me këtë vendim në rastin e shënimit të "Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë", me çmimin "Krenaria e Sportit të Vushtrrisë" nderohet **Klubi i Hendbollit "Samadrexha F" U-18**, për të arriturat e tij në gara sportive nacionale, në ç' rast janë shpallur Kampion në Super Ligën e Republikë së Kosovës.
2. Dorëzimi i këtij çmimi bëhet në mënyrë solemne nga Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, në ditën e shënimit të kësaj date, më 17 qershor 2025.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

Arsyetim

Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më datën 19.05.2025, ka shqyrtuar propozim-vendimin për Ndarjen e Dekoratave, në ç' rast ka propozuar që në kuadër të ditës së Çlirimit të Vushtrrisë me Çmimin "Krenaria e Sportit" të nderohet **Klubi i Hendbollit "Samadrexha F" U-18**, për të arriturat e tyre në grat nacionale si kampion në Super Ligën e Republikë së Kosovës, e njëkohësisht edhe për pjesëmarrje në garat në arenën ndërkombëtare.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vucitrn – Municipality of Vushtrri



Drejtoria për Arsim

DATE /A:	05.05.2025
NR.	10.Nr. 364 /25
PËR:	Kuvendi Komunal
PËRMES:	z. Ferit Idrizi Kryetar i Komunës së Vushtrrisë
NGA:	Albanez Tahiraj, Drejtore i DKA-së
Lënda:	Propozim – vendim për formimin e Komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në Komunën e Vushtrrisë.

Bazuar në nenin 5 pika (d) të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 , nenit 35 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032. Rregullores (QRK) Nr.19/2024, për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zv. drejtorëve, mësimdhënësve bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo – arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar, dhe Nenit 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës. Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më, _____ miraton këtë:

V E N D I M

PËR EMËRIM TË KOMISIONIT PËR PËRZGJEDHJEN E DREJTORËVE DHE ZËVENDËSDREJTORËVE NË KOMUNËN E VUSHTRRISË

- Me këtë vendim formohet Komisionit për përzgjedhje për vendet e punës: drejtor dhe zëvendësdrejtor, në shkollat fillore, të mesme të ulëta në Komunën e Vushtrrisë, me këtë përbërje:
 - 1.1. Sadete Gërguri, zyrtare e DKA-së
 - 1.2. Ferit Avdiu, drejtor i SHFMU “7 Marsi”, Bukosh
 - 1.3. _____, përfaqësues i MASHT-it
 - Komisioni do t'i zhvillojë të gjitha procedurat për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në
 - Komunën e Vushtrrisë, konform Rregullores (QRK) Nr.19/2024, për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zv. drejtorëve, mësimdhënësve bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo – arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar.
 - Komisioni i cekur si në nenin 1 të këtij vendimi ka mandat ad hoc.
 - Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Komisioni i lartcekur.
 - Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.
- Kryesuesja e Kuvendit

Melihate Basholli Latifi



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA VUSHITRRI - OPŠTINA VUČITRN - MUNICIPALITY OF VUSHITRRI



Formulari per kerkese apo ankese

Drejtatori/Njesia

Kuvendi i Komunës

Data 05/05/2025

1. Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:

Emri dhe mbiemri

Ajmane Ferati Shatrolli

Numri personal

2003915827

Adresa e vendbanimit

Vushitri

E-mail Adresa

Numri i tel. fiks

Numri i tel. mobil

44293676

2. Mënyra e pranimit

Statusi i lëndës

Kërkesa

Ne proces

Vlera për pagesë: 0.00

3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:

Kerkese per mbeshtetje financiare

Mos shkruani në këtë pjesë

Numri i protokolit

01-104/02-0019241/25

Afati i zgjedhjes

04/06/2025

Vendimi

4. Dokumentet e bashkangjitura:

Nr. Lloji i dokumentit

5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi

Unë Ajmane Ferati Shatrolli vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

A. Shatrolli
(Nënshkrimi)

*Ju lutemi të kërkonit nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura

Pranuar nga: florjana.krasniqi

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve / Ministarstvo za Finansije, Rada i Transfere / Ministry of Finance, Labour and Transfers

DATE/A:	15.05.2025
PËR/ZA/TO:	Ministrat, Kryetarët e Komunave, Kryeshefat e Agjensioneve, Udhëheqësit e Organizatave buxhetore, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Zyrtarët Kryesor Financiar,
NGA/OD/FROM:	Hekuran Murati, Ministër në Ministrinë e Financave, Punë dhe Transfereve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkorja Buxhetore 2026/01

Hekuran Murati
Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve

Per: 



Qarkorja Buxhetore 2026/01

1. Qëllimi

Në përputhje me nenin 20 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ministri për Financa, Punë dhe Transfere është i autorizuar dhe përgjegjës të lëshojë qarkore buxhetore për cilëndo ose të gjitha organizatat buxhetore, me qëllim të ofrimit të udhëzimeve për përgatitjen e Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Në mbështetje të kësaj dispozite ligjore, Ministri lëshon Qarkoren Buxhetore 2026/01, e cila përmban udhëzimet e para për hartimin e buxhetit për vitin 2026, si dhe vlerësimet për vitet 2027 dhe 2028. Kjo qarkore përfshin gjithashtu kalendarin kohor indikativ për procesin buxhetor dhe kufijtë fillestarë buxhetorë për vitin 2026, përkatësisht vlerësimet për vitet 2027-2028 për secilën organizatë buxhetore.

Në rast nevojë, pas kësaj qarkoreje do të lëshohen edhe qarkore të tjera plotësuese deri në finalizimin e plotë të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2026 dhe vlerësimeve për vitet pasuese.

2. Konteksti për përgatitjen e buxhetit për 2026-2028

Planifikimi i buxhetit për vitin 2026 mbështet në Deklaratën e Prioriteteve të Qeverisë 2026-2028 dhe kornizën makro-fiskale për të njëjtën periudhë. Qeveria është e përkushtuar që duke ruajtur stabilitetin fiskal të përkrahë kërkesat e organizatave buxhetore, në përputhje me orientimet sektorial buxhetor dhe prioritetet e përcaktuara në Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë.

Objektivat strategjike të Qeverisë janë përcaktuar përmes Programit të Qeverisë, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim, dhe strategjive sektoriale, si dhe nëpërmjet dokumenteve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian, si Programi për Reforma në Ekonomi 2025-2027 dhe Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Prioritetet e Qeverisë për periudhën trevjeçare të ardhshme përqendrohen në ri-orientimin e ekonomisë drejt prodhimit dhe eksportit, rritjen e punësimit, dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm, që mbrojnë mjedisin dhe sigurojnë ruajtjen e tij për brezat e ardhshëm. Po ashtu, një tjetër prioritet është orientimi drejt transformimit digjital.

Projeksionet fiskale kanë përcaktuar burimet e mundshme të financimit që Qeveria mund të disponojë për shpenzime në vitin 2026, si dhe vlerësimet për vitet 2027-2028. Çdo tejkalim i kufijve të shpenzimeve të përcaktuara në këtë qarkore do të bëjë të detyrueshëm ndryshimin e burimeve të financimit, përfshirë mundësinë e rritjes së burimeve të financimit dhe/ose ndryshimin e politikave tatimore për të siguruar të hyra shtesë.

Gjatë procesit të hartimit të buxhetit, duhet të merren parasysh zotimet tona ndaj institucioneve financiare ndërkombëtare. Në këtë kuadër, Qarkorja Buxhetore 2026/01 është hartuar në përputhje me obligimet e deritanishme nga marrëveshjet financiare ekzistuese dhe ato në proces negociate, duke pasqyruar përkushtimet për politikën fiskale në përputhje me kërkesat e Fondit Monetar Ndërkombëtar.

3. Parashikimet për implementimin e buxhetit 2026

Para paraqitjes së kërkesave buxhetore për vitin 2026, organizatat buxhetore duhet të paraqesin në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve një parashikim të realizimit të buxhetit për vitin 2025, deri në fund të tij, në nivelin e programeve, nën-programeve, kategorive të shpenzimeve dhe projekteve individuale. Gjithashtu, organizatat buxhetore janë të obliguara të identifikojnë dhe të informojnë Ministrinë për nënshpenzimet eventuale në buxhetin aktual, si dhe për pritshmëritë për mbi-shpenzimet para se të paraqesin kërkesat buxhetore për vitin 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027-2028.

4. Kriteret e përgjithshme për përgatitjen e buxhetit për 2026-2028

Procesi buxhetor për vitet 2026-2028 ka për qëllim të lidhi planet dhe politikat buxhetore me prioritetet e Qeverisë. Në nivel sektorial, kjo është realizuar duke prioritetizuar sektorët buxhetorë sipas projeksioneve për periudhën 2026-2028. Përmes kësaj qarkoreje, kërkohet që organizatat buxhetore të konkretizojnë kërkesat e paraqitura, duke detajuar përgatitjen e buxhetit në nivelin e programeve, nën-programeve, kategorive të shpenzimeve dhe projekteve specifike.

Kërkesat për shpenzime të reja duhet të paraqiten vetëm nëse ka hapësirë fiskale të lirë dhe nëse ato janë përfshirë në projeksionet për periudhën 2026-2028. Gjatë procesit buxhetor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve duhet të sigurohet që totali i shpenzimeve për të gjitha organizatat brenda një sektori të mos e kalojë shumën e parashikuar në projeksionet për sektorin për vitet 2026-2028.

Organizatat buxhetore duhet të kenë parasysh që gjatë përgatitjes së kërkesave të tyre, t'u japin prioritet:

- Projekteve që kontribuojnë në realizimin e prioritetëve të Qeverisë dhe dokumenteve strategjike.
- Projekteve që janë në vazhdimësi nga vitet e kaluar dhe kanë obligime kontraktuale, përfshirë edhe ato të shpronësimit të lidhura me këto projekte.
- Zotimeve të Qeverisë për Planin e Veprimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe për programin Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA).
- Legjislacionit të ri ose ndryshimit dhe plotësimit të legjislacionit ekzistues.
- Obligimeve për financim të jashtëm për projekte individuale, të cilat duhet të përfshihen brenda ndarjeve buxhetore.
- Aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me Agjendën e reformave në kuadër të Planit të rritjes.

Procesi i planifikimit të buxhetit duhet të përfshijë këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël;
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës;
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale;
- Prezantimi në formë të tabelës mbi burimet e financimit dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve për vitin 2026 dhe projeksionet për vitet 2027-2028 dhe



- Gjatë procesit buxhetor vëmendje e shtuar duhet t'i jepet nga OB-të në nivel qendror dhe lokal zbatimit të çështjeve si në vijim:
 - OB-të të mos propozojnë aktivitete apo projekte të reja pa i dhënë prioritet buxhetimit të obligimeve për aktivitetet/projektet kapitale. Në përputhje me rekomandimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, OB-të të dërgojnë në MFPT informatë lidhur me paditë e ngritura së bashku me një vlerësim nga zyrat ligjore për mundësinë e materializimit/shndërrimit të tyre në obligime;
 - OB-të janë të obliguara të plotësojnë të dhënat që kërkohen në sistemet buxhetore SZHMB dhe PIP si dhe duhet të parandalojnë keq klasifikimin e shpenzimeve buxhetore. Nëse me rastin e dorëzimit të propozim buxhetit nga OB qendrore apo lokale analisti buxhetor do të identifikojë keq klasifikimet, Departamenti i Buxhetit të njëjtat do t'i largojë nga buxheti, duke përfshirë jo vetëm keq klasifikimet për projektet e reja por edhe ato që janë në vazhdimësi nga viti i kaluar;
 - Projektet e propozuara kapitale të jenë projekte në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse. Projektet të cilat nuk zbatojnë standardet dhe kriteret e parapara ligjore nuk do të lejohen të bëhen pjesë e buxhetit.
 - Me rastin e propozimit të projekteve të reja kapitale, OB-të të dorëzojnë në MFPT arsyeshmërinë për secilin projekt sipas rregullave të sistemit PIP dhe udhëzimeve administrative përkatëse.;
 - Nga OB-të kërkohet që të bëhet regjistrimi i zotimeve shumëvjeçare në sistemin PIP; Ministrinë duhet të ndajnë mjete buxhetore brenda hapësirës fiskale vetëm për realizimin e atyre projekteve kapitale për të cilat në bazë marrëveshjeve të mirëkuptimit me komunat kanë krijuar obligime në të kaluarën;
 - Buxheti i projekteve kapitale të bëhet në përputhje me rregullat në fuqi, ku pjesë e kostos së projektit të jenë edhe *shpenzimet e shpronësimit*. Organizatat buxhetore qendrore dhe lokale, pas një analize paraprake, duhet të planifikojnë shpenzimet e shpronësimit për çdo projekt individual në kuadër të kostos totale të projektit, e jo të planifikojnë linjë të veçantë për shpronësim.
 - Për projektet e reja kapitale të natyrës teknologjisë informative Organizatat Buxhetore para se të aplikojnë për mjete buxhetore duhet të marrin miratim paraprak nga Agjencia e Shërbimit të Informacionit- ASHI (MPB) se një projekt të tillë nuk mund të zbatohet nga ASHI-ja.

Qeveria mund të ndryshojë strukturën e shpenzimeve me qëllim arritjen e prioritetëve të saj, si brenda programeve të një organizate buxhetore, ashtu edhe duke zhvendosur buxhetin nga një organizatë në tjetrën të nivelit qendror, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kërkesat buxhetore duhet të mbështesin politikat prioritare të Qeverisë dhe të fokusohen në fushat e politikave sektoriale, në përputhje me Deklaratën e Prioritetëve Afatmesme të Qeverisë 2026-2028.

Shpenzimet rrjedhëse: Organizatat buxhetore duhet të paraqesin kërkesat e tyre brenda kufizimeve buxhetore të caktuara. Është thelbësore që të gjitha organizatat buxhetore të respektojnë kufijtë e përcaktuar në Shtojcat e bashkangjitura.

Punësimi: Pozitat e reja do të lejohen vetëm brenda numrit të aprovuar të pozitave dhe buxhetit për pozitat e paplotësuara sipas udhëzimeve të dhëna me qarkore.

Pagat dhe shtesat: Për kalkulimin e pagave për vitin 2026 për pozitat aktuale është marrë për bazë për përllogaritje muaji mars 2025 duke përfshirë rritjen e planifikuar të koeficientit për 0.5 sipas Ligjit

mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025. Ndërsa për punëtorët e papunësuar është përlogaritur paga mesatare dhe është buxhetuar vetëm deri 40%, brenda kufizimeve buxhetore.

Mallra dhe shërbime: Organizatave buxhetore do t'i mundësohet financimi në fushat e rëndësishme dhe të domosdoshme. Organizatat buxhetore duhet të identifikojnë burimet brenda skenarëve bazë të tyre nga ato fusha me performancë jo të mirë, ose që nuk janë në përputhje të mjaftueshme me prioritetet e nivelit të lartë të Qeverisë.

Shpenzimet komunale: priten të ketë pjesëmarrje përafërsisht të njëjtë krahasuar me vitin 2025.

Subvencionet dhe transferet: Në kuadër të kësaj kategorie do të vazhdohet me ndarjen e mjeteve për zbatimin e skemave sociale dhe pensionale përfshirë këtu edhe rritjen natyrale të skemave pensionale, subvencionimet në bujqësi si dhe politikat e reja tani më të aprovuara në Qeveri.

Investimet kapitale: përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve të përgjithshme dhe, në periudhën afatmesme, pritet të përfaqësojnë rreth 26% të shpenzimeve totale. Gjatë kësaj periudhe, pritet të realizohen projekte kapitale të bazuara në një listë prioritetesh, që përfshijnë iniciativa me ndikim në përmirësimin e rrjetit të transportit, përmirësimin e rrjetit të energjisë elektrike, si dhe përmirësimin e kushteve në sektorët e arsimit, shëndetësisë, sistemit social, mbrojtjes dhe sigurisë, etj. Pjesa më e madhe e investimeve kapitale gjatë periudhës afatmesme pritet të financohet nga buxheti i rregullt, ndërkohë që një numër i madh i projekteve në sektorë të ndryshëm planifikohen të financohen përmes huazimit të jashtëm, duke përdorur klauzolën e investimeve.

Përparësi në financim do të kenë projektet që janë në fazën e realizimit, si dhe ato që janë plotësisht në përputhje me prioritetet e Qeverisë. Kufijtë buxhetorë për investimet kapitale nëpër organizatat buxhetore janë indikativë, dhe Qeveria mban të drejtën t'i rregullojë ata në përputhje me arsyeshmërinë e projekteve që propozohen nga organizatat buxhetore.

Për organizatat buxhetore që konkurrojnë për fonde huamarrjeje (nga deficitin buxhetor prej 2%, përmes fondit 04) dhe nga klauzola e investimeve – përmes fondit 06 (ku aplikimi për fonde nga klauzola mund të bëhet vetëm për projekte kapitale), është e domosdoshme që projektet të përmbushin kriteret e përmendura më parë. Kjo përfshin gjithashtu analizën e shpenzimeve rrjedhëse para, gjatë dhe pas përfundimit të projektit, të cilat duhet të jenë të përshtatshme dhe të përfshira në projekSIONET financiare të organizatës buxhetore.

5. Programi për investime publike (PIP)

Planifikimi i buxhetit për investime kapitale realizohet nëpërmjet rregullave dhe sistemit të Programit për Investime Publike (PIP). Prioritetet strategjike të Qeverisë, të përcaktuara në “Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë 2026–2028”, përbëjnë bazën për përgatitjen e kërkesave buxhetore dhe për identifikimin e projekteve kapitale.

6. Indikatorët e performancës

Organizatat buxhetore, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë komunal, janë të obliguara të prezantojnë indikatorët e performancës të përmbledhur sipas objektivave dhe aktiviteteve përkatëse në nivelin e tyre organizativ, në përputhje me nenin 21 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Çdo organizatë buxhetore duhet të paraqesë nga 1 deri në 5

objektiva, të cilat lidhen drejtpërdrejt me strategjitë përkatëse dhe mbulojnë programet më të rëndësishme të saj. Udhëzimi parashikon që, aty ku është e aplikueshme, të paktën një nga objektivat e paraqitura të synojë promovimin e barazisë gjinore, i shoqëruar me indikatorë të performancës dhe aktivitetet konkrete për realizimin e tij. Gjithashtu, çdo kërkesë për fonde shtesë duhet të shoqërohet me një arsyetim të qartë se si ajo ndihmon në arritjen e objektivave të organizatës. Organizatat buxhetore duhet të rishqyrtojnë aktivitetet e tyre në funksion të arritjes së këtyre objektivave, ndërsa indikatorët për matjen e performancës së aktiviteteve duhet të jenë të qartë, të matshëm dhe konkretë për secilin aktivitet.

Forma e ofrimit të këtyre informatave dhe një shembull konkret janë dhënë në Aneksin 2. Për secilën organizatë buxhetore duhet të ofrohen informacionet e mëposhtme:

- **Objektivat e outputit:** Këto përshkruajnë rezultatet e pritshme nga ofrimi i shërbimeve, të cilat janë nën kontrollin e organizatës buxhetore.
- **Treguesit e outputit:** Këta tregues matnin aktivitetin e institucionit, si p.sh. sasinë apo cilësinë e shërbimit ose produktit të ofruar.
 - a) Indikatorit treguesi bazë
 - b) Indikatorit treguesi i synuar
- **Aktivitetet:** Këto përshkruajnë veprimet që do të ndërmerren për arritjen e objektivave të deklaruara.

7. Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ)

Duke vepruar në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020 (2015), institucionet e Kosovës kanë përgjegjësinë për “përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i domosdoshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve” (Neni 5.1.5.). Për këtë arsye, organizatat buxhetore duhet të pasqyrojnë ndikimin e shpenzimeve publike në barazinë gjinore në buxhetin vjetor për vitin 2026. Kjo do të kontribuon gjithashtu në rritjen e efektivitetit dhe transparencës në menaxhimin e financave publike. Komunitat duhet të marrin parasysh këto udhëzime gjatë hartimit të qarkores së brendshme buxhetore komunale, e cila do të shërbejë si dokument bazë për planifikimin e buxhetit komunal për periudhën 2026-2028. Në rast të paqartësive, organizatat buxhetore mund të kërkojnë ndihmë nga analistët përkatës në kuadër të Departamentit të Buxhetit në Ministrinë e Financave. Forma e ofrimit të këtyre informacionave është dhënë në Aneksin 1. Po ashtu, organizatat buxhetore duhet të publikojnë këto të dhëna.

8. Kufijtë buxhetor për organizatat buxhetore të nivelit qendror për 2026-2028

Organizatat buxhetore të nivelit qendror duhet të marrin parasysh kufijtë buxhetorë të dhënë në tabelën e mëposhtme gjatë përgatitjes së buxhetit të tyre për vitin 2026 dhe për dy vitet në vijim.

Ju lutemi të keni parasysh se këta kufij buxhetorë mund të ndryshojnë në varësi të lëvizjeve fiskale apo vendimeve të Qeverisë, të cilat do të pasqyrohen përmes Qarkoreve Buxhetore pasuese, si dhe në varësi të kualitetit të kërkesave buxhetore.

Më poshtë në Tabelën 1 janë kufijtë buxhetor për organizatat buxhetore qendrore për 2026-2028.

Shtojca 1. Vlersimet per vitet 2026-2028

Kodi org.	Ministritë/Institucionet	Vlersimet për vitin 2026							Vlerësimet për vitin 2027			Vlerësimet për vitin 2028			
		Numri Aprovuar	Paga dhe Shtesa	Maltra dhe Shërbime	Shpenzimet Kommunele	Subvencione dhe Transfere	Investimet Kapitale	Rezerva	Total 2026	Shpenzime Operative	Shpenzime Kapitale	Total 2027	Shpenzime Operative	Shpenzime Kapitale	Total 2028
101	Kuvendi i Kosovës	528	8,098,353	1,558,000	200,000	70,000	200,000	-	10,126,353	10,671,763	200,000	10,871,763	11,141,670	200,000	11,341,670
102	Zyra e Presidentit	113	1,621,527	2,246,421	6,700	419,305	15,000	-	4,308,953	4,383,137	15,000	4,398,137	4,477,226	15,000	4,492,226
104	Zyra e Kryeministrit	609	5,551,518	7,047,500	88,226	7,505,687	1,000,000	-	21,192,931	17,521,912	1,500,000	19,021,912	17,994,038	1,500,000	19,494,038
201	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	2,693	29,251,955	15,910,661	897,576	1,074,860,661	24,850,000	-	1,145,770,853	1,171,440,122	48,350,000	1,219,790,122	1,284,415,749	85,000,000	1,369,415,749
203	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	937	8,245,496	6,000,000	264,783	77,630,000	3,544,000	-	95,684,279	93,143,781	5,544,000	98,687,781	93,622,226	5,544,000	99,166,226
204	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	331	3,014,452	5,500,000	158,280	8,246,000	10,320,000	-	27,238,732	21,084,526	14,320,000	35,404,526	21,259,440	14,320,000	35,579,440
205	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	636	6,132,762	37,605,515	481,490	1,643,814	264,977,687	-	310,841,268	52,087,781	271,038,265	323,126,046	48,943,634	261,538,625	310,482,259
206	Ministria e Shëndetësisë	1,482	18,873,544	38,097,600	281,848	2,813,805	36,341,050	-	96,407,847	56,379,842	33,010,750	89,390,592	63,137,879	28,980,750	92,118,629
220	Sherbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosoves	7,538	101,490,732	69,600,000	4,139,016	-	22,449,500	-	197,679,248	180,911,738	22,449,500	203,361,238	187,100,738	23,000,000	210,100,738
207	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	831	8,550,336	5,550,000	383,908	17,116,550	66,440,000	-	98,040,794	32,071,063	96,440,000	128,511,063	32,567,196	96,440,000	129,007,196
208	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	2,282	25,954,911	14,350,000	1,590,459	25,305,360	42,862,054	-	110,062,784	69,678,250	49,862,054	119,540,304	71,047,371	49,862,054	120,909,425
211	Ministria për Komunitete dhe Kthim	121	1,102,753	375,000	17,000	2,100,000	2,000,000	-	5,594,753	3,655,405	2,000,000	5,655,405	3,719,392	2,000,000	5,719,392
212	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	129	1,247,573	335,000	7,000	1,000,000	4,050,000	-	6,639,573	2,758,189	4,050,000	6,808,189	2,830,580	4,050,000	6,880,580
213	Ministria e Ekonomisë	204	1,849,894	5,800,000	23,130	24,352,870	46,931,926	-	78,957,820	31,974,545	48,052,196	80,026,741	28,939,015	21,600,000	50,539,015
214	Ministria e Punëve të Brendshme	11,901	136,800,926	44,270,623	4,450,400	2,171,367	60,189,023	-	247,882,339	193,005,617	62,218,773	255,224,390	200,543,490	62,218,773	262,762,263
215	Ministria e Drejtësisë	2,169	21,660,702	12,500,000	1,088,769	11,898,000	9,800,000	-	56,947,471	46,067,810	7,000,000	53,067,810	47,324,672	7,000,000	54,324,672
216	Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diaspores	389	8,842,498	23,935,000	839,551	2,000,000	16,395,000	-	52,012,049	36,074,386	16,395,000	52,469,386	36,588,472	16,395,000	52,983,472
217	Ministria e Mbrojtjes	5,479	53,381,701	45,905,600	1,169,000	-	115,641,260	-	216,097,561	109,862,295	112,441,260	222,303,555	112,959,768	112,441,260	225,401,028
221	Ministria e Zhvillimit Rajonal	60	733,939	335,000	1,360	2,000,000	2,000,000	-	5,070,299	3,120,666	2,000,000	5,120,666	3,159,381	2,000,000	5,159,381
230	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	42	512,805	310,000	5,000	-	100,000	-	927,805	856,000	100,000	956,009	885,765	100,000	985,765
231	Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës	20	288,878	930,000	5,000	790,159	-	-	2,014,037	2,029,925	-	2,029,925	2,046,688	-	2,046,688
235	Autoriteti i Rregullatorit i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	42	572,220	785,000	18,200	-	600,000	-	1,975,420	1,406,892	600,000	2,006,892	1,440,096	600,000	2,040,096
236	Agjencioni për parandalim e korruptcionit	58	831,165	140,000	8,500	-	-	-	979,665	1,030,379	-	1,030,379	1,078,607	-	1,078,607
238	Zyra Rregullatorit për Energji	41	588,672	270,000	22,000	-	80,800	-	961,472	913,049	80,800	993,849	947,207	80,800	1,028,007
240	Organi Shqiptues i Prokurimit	35	391,824	160,000	5,100	-	-	-	556,924	578,475	-	578,475	601,210	-	601,210
242	Universiteti i Prishtinës	2,081	23,562,238	4,200,000	1,020,000	1,744,000	5,400,000	-	35,926,238	32,322,161	5,400,000	37,722,161	33,939,360	5,400,000	39,339,360
243	Gjykata Kushtetuese e Kosoves	72	1,446,766	705,000	10,800	165,080	110,000	-	2,437,646	2,407,218	110,000	2,517,218	2,491,166	110,000	2,601,166
244	Autoriteti Kosovar i Konkurencës	30	393,188	77,000	2,000	-	-	-	472,188	496,813	-	496,813	521,628	-	521,628
245	Agjencioni Kosovar i Intelejencës	190	8,215,730	4,000,000	45,000	700,000	4,270,000	-	17,230,730	13,412,595	4,270,000	17,682,595	14,039,313	4,500,000	18,539,313
246	Këshilli i Kosovës për Trashigimi Kulturore	18	275,445	107,000	2,550	-	-	-	384,995	400,144	-	400,144	416,127	-	416,127
247	Paneli Zgjedhor per Ankesa dhe Parashtesa	21	311,805	58,000	7,820	-	-	-	377,625	396,775	-	396,775	414,867	-	414,867
249	Këshilli i Pavarur Mbrojtës për Sherbinin Civil të Kosovës	38	502,628	160,000	3,825	-	-	-	666,453	694,098	-	694,098	743,263	-	743,263
250	Keshilli Prokurororial i Kosoves	969	13,837,463	3,450,000	199,630	-	2,134,500	-	19,621,593	18,248,153	2,134,500	20,382,653	19,051,072	2,134,500	21,185,572
302	Zyra Kombetare e Auditimit	185	2,666,915	826,100	40,000	-	-	-	3,533,015	3,679,695	-	3,679,695	3,834,443	-	3,834,443
313	Autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit	21	260,678	143,000	6,503	-	-	-	410,181	424,518	-	424,518	439,644	-	439,644
314	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	29	303,789	127,000	6,400	10,000	-	-	447,189	453,898	-	453,898	471,525	-	471,525
317	Autoriteti i Aviacionit Civil	31	717,138	150,000	3,738	-	-	-	870,876	910,319	-	910,319	948,148	-	948,148
318	Komisioni i Pavarur i Minerave dhe Mineraleve	77	964,054	409,281	20,600	-	200,000	-	1,593,935	1,446,958	200,000	1,646,958	1,502,897	200,000	1,702,897
319	Komisioni i Pavarur i Mediave	44	556,650	409,883	28,000	-	400,000	-	1,394,533	1,025,149	-	1,025,149	1,057,449	-	1,057,449
320	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	93	1,267,441	700,000	28,100	4,800,000	-	-	6,795,541	6,865,250	-	6,865,250	6,958,793	-	6,958,793
321	Institucioni i Avokatit të Popullit	78	1,066,535	355,000	8,000	-	60,000	-	1,489,535	1,489,194	60,000	1,549,194	1,551,080	60,000	1,611,080
322	Akademia e Drejtësisë	32	336,504	535,000	16,500	-	-	-	888,004	906,511	-	906,511	926,037	-	926,037
328	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	2,321	28,251,055	5,193,000	650,000	500,000	3,920,000	-	38,514,055	36,147,863	3,920,000	40,067,863	37,787,131	3,920,000	41,707,131
329	Agjencia Kosovare për krahasim dhe Verifikim të Pronës	200	1,845,875	851,090	48,523	-	431,500	-	3,176,988	2,847,011	431,500	3,278,511	2,954,118	431,500	3,385,618
251	Agjensioni per Informim dhe Privatesi	34	388,748	144,000	2,450	-	-	-	535,198	556,580	-	556,580	579,137	-	579,137
232	Shpenzimet e Paparashikuara					1,930,000	4,800,000	-	6,730,000	4,800,000	1,930,000	6,730,000	4,800,000	1,930,000	6,730,000
248	Radio Televizioni i Kosovës					8,960,000	-	-	8,960,000	8,960,000	-	8,960,000	8,960,000	-	8,960,000
224	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore	52	509,992	300,000	25,000	10,000,000	-	-	10,834,992	10,963,042	-	10,963,042	11,042,634	-	11,042,634
255	Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar	25	416,362	280,000	10,000	-	200,000	-	906,362	736,262	150,000	886,262	760,422	150,000	910,422
	Totali	45,311	533,688,136	362,697,274	18,337,735	1,288,792,658	749,853,300	4,800,000	2,958,169,103	2,293,297,765	816,273,598	3,109,571,363	2,434,961,765	813,722,262	3,248,684,027
239	Agjencioni Kosovar i Privatizimit	242	3,665,947	1,025,000	110,000	2,000	30,000	-	4,832,947	5,004,574	20,000	5,024,574	5,217,291	20,000	5,237,291
	Totali i përgjithshëm me AKP	45,553	537,354,083	363,722,274	18,447,735	1,288,794,658	749,883,300	4,800,000	2,963,002,050	2,298,302,339	816,293,598	3,114,595,937	2,440,179,055	813,742,262	3,253,921,317



9. Fazat e procesit buxhetor për vitin 2026 për nivelin qendror

Pjesa në vijim prezanton kalendarin kohor të buxhetit, hapat dhe veprimet gjatë procesit buxhetor për vitin 2026.

- **15 Maj** - Lëshimi i Qarkores së parë buxhetore 2026/01. Kjo qarkore përmban udhëzimet për procesin buxhetor, kufijtë buxhetor dhe kalendarin buxhetor.
- **26 Qershor** - Organizatat buxhetore duhet të dorëzojnë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) kërkesat buxhetore sipas dokumentacionit përkatës, duke i përshkruar programet dhe kategoritë e shpenzimeve. Kërkesat duhet të jenë të plotësuara dhe të arsyetuara përmes përdorimit të sistemit të SZHMB-së dhe PIP-it.
- **27 Qershor** - Departamenti i Makroekonomisë paraqet kornizën e re makro-fiskale, e cila përcakton parametrat e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin buxhetor 2026.
- **11 Korrik** - Lëshimi i Qarkores së dytë buxhetore 2026/02, e cila do të adresojë çështjet specifike të reja që kanë dalë pas lëshimit të Qarkores së parë buxhetore.
